

Raporti Vjetor 2024

Raporti Vjetor 2024

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

Adresa: Bulevardi “Zhan
D’Ark”, Prona nr. 33, ish-Shtëpia e
Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@dppi.gov.al
Web: www.dppi.gov.al
Numri i Gjellbër: 0800 1993

TABELA E LËNDËS

PRONËSIA INDUSTRIALE	7
FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË PRONËSISË INDUSTRIALE	9
QËLLIMI I VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE	13
Statusi	13
Misioni	13
Fokusi	13
Objektivat	14
TË DHËNA STATISTIKORE PËR OBJEKTET E PRONËSISË INDUSTRIALE DREJTORIA E EKZAMINIMIT	14
Sektori i Markave Tregtare, Disenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografikë	14
Aplikime për regjistrim marke nga Marrëveshja e Madridit (Markat Ndërkombëtare)	15
Certifikata regjistrimi të lëshuara nga DPPI	16
Aplikime për Ripërtëritje Marke	16
Aplikime për regjistrim për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës	17
Disenjot Industriale në Republikën e Shqipërisë	18
DHOMA PËR SHQYRTIMIN E KUNDËRSHTIMEVE	19
PATENTAT PËR SHPIKJE DHE MODELET E PËRDORIMIT	20
Realizimet	20
Të dhëna statistikore për vitin 2024	20
Aplikime për Patenta	20
Statistika të ekzaminimit të Patentave	24
Sektori i Pritjes dhe i Informacionit	29

VEPRIMTARIA E KOORDINIMIT DHE E PROMOVIMIT TË AKTIVITETEVE NDËRGJEGJËSUESE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE, ME TË GJITHA GRUPET E INTERESIT	31
AKTIVITETET KRYESORE TË VITIT 2024	31
BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE WIPO/ EPO/ EUIPO	36
MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT	42
Sektori i Promovimit dhe Qendra e Trajnimeve	45
ARSIMI DHE PI	48
Qendra e Trajnimeve	50
DPPI NË MEDIA	58
INICIATIVA LIGJORE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE	59
SEKTORI JURIDIK	59
DHOMA PËR SHFUQIZIM/ZHVLERËSIM	62
ÇËSHTJE NË GJYKATË	63
FINANCA DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE	64
Forcimi i Kapaciteteve Administrative	64
Të ardhurat	64
PROCESI I INTEGRIMIT EUROPIAN	65
STRATEGJIA E RE KOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE 2022-2025	66
MIRËNJOHJE	68

SHKURTIME:

DPPI - Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

MEKI – Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

BE - Bashkimi Europian

EPO - European Patent Office

EUIPO - European Union Intellectual Property Office

INTA - Shoqata Ndërkombëtare e Markave Tregtare

OBPI - Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

PI - Pronësia Intelektuale

PKIE- Plani Kombëtar për Integrimin Europian

QTT - Qendrat e Transferimit të Teknologjisë

QITSH - Qendrat e Informacionit Teknik-Shkencor

ZBEPI - Zyra e Bashkimit Europian për Pronësinë Intelektuale

ZEP - Zyra Europiane e Patentave

WIPO - Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

TGJ- Tregues Gjeografik

EO – Emërtim Origjine

DAP – Departamenti i Administratës Publike

HYRJE

PRONËSIA INDUSTRIALE

Ky raport, kryesisht, tregon dhe reflekton zbatimin, ndikimin, perspektivën e standardeve si dhe efikasitetin e stafit si specialistë profesionistë në fushën e pronësisë industriale. Raporti bazohet në të dhënat statistikore të drejtorive dhe sektorëve përbërës të DPPI-së mbi punën e kryer gjatë vitit 2024. Raporti Vjetor i DPPI-së shërben si një urë komunikimi për të përhapur në mënyrë transparente njohuri të ndryshme rreth Drejtorisë dhe punës së saj voluminoze me lexuesin. Gjithashtu, ky raport i shërben zbatimit aktual të ligjit për pronësinë industriale dhe për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e kësaj të fundit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale përcakton në mënyrë të qartë strategjitë dhe objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm për të përmbushur në mënyrë të plotë vizionin e saj.

Objektivi kryesor i DPPI-së është të ofrojë mbrojtjen e pronësisë industriale në të njëjtin nivel me vendet europiane. Detyra e saj është të rrisë cilësinë e ekzaminimit të objekteve të pronësisë industriale si dhe të ndërgjegjësojë publikun e gjerë mbi rëndësinë e të drejtave që përfitohen nga regjistrimi i tyre. Të mirat dhe përfitimet që burojnë nga mbrojtja e objekteve të pronësisë industriale janë faktorë nxitës për zhvillimin ekonomik të bizneseve, si dhe ndihmojnë në vendosjen e konkurrencës së ndershme në tregun ku ata operojnë, duke i kthyer në kontribuues të vyer në rritjen e ekonomisë së vendit.

Është kjo arsyeja themelore përse është tejet e rëndësishme të ngrihet një sistem kombëtar funksional dhe i besueshëm i pronësisë industriale, i cili krijon, rrjedhimisht, një mjedis stimulues, ku bizneset, industritë dhe individët ndihen të sigurt se puna dhe investimi i tyre janë të mbrojtur nga vjedhja, falsifikimi dhe keqpërdorimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale përbën një hallkë kyçe të këtij sistemi, pasi është i vetmi institucion politikëbërës dhe përfaqësues i Shqipërisë pranë organizatave botërore, për çështjet që i takojnë pronësisë intelektuale.

Komisioni European, në “Kapitullin 7” të raportit të vitit 2023 për Republikën e Shqipërisë, është shprehur se:

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për të drejtat e pronësisë intelektuale.

Të harmonizojë më tej legjislacionin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, me *acquis* të BE-së;

Të përmirësojë funksionimin e agjencive të menaxhimit kolektiv dhe pagesat e honorareve për mbajtësit e këtyre të drejtave;

Të harmonizojë më tej legjislacionin për të drejtat e pronësisë industriale dhe sistemin e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.


Duke pasur parasysh se çfarë u tha më lart, si dhe me besimin dhe vullnetin e plotë që zhvillimi i sistemit të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë është në rrugën e duhur, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, me vendosmëri dhe përkushtim, do të vazhdojë të çojë përpara zhvillimin e bashkëpunimeve dhe negociatave, me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit në këtë fushë, për të përmbushur jo vetëm misionin e saj, por edhe për të nxitur zhvillimin e inovacionit në vend.

FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË PRONËSISË INDUSTRIALE

I nderuar lexues,
Përmes publikimit të raportit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, kam kënaqësinë të ndaj me ju punën dhe veprimtarinë e kryer prej këtij institucioni gjatë vitit 2024.

Ky raport është një mjet i rëndësishëm transparence dhe llogaridhënieje, në të cilin drejtoria jonë synon të paraqesë rezultatet dhe punën e kryer përgjatë harkut kohor të këtij viti kalendarik.

Viti 2024 është mbyllur me rezultate të kënaqshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Shifrat e këtij viti janë pasqyrim i punës së palodhur për ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale, jo vetëm të biznesit vendës, por edhe të kompanive të huaja të cilat kanë treguar interes për tregun shqiptar.



Dua të përmend gjithashtu, se këto rezultate janë reflektim i punës së të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin e Pronësisë Industriale, të cilët kanë luajtur një rol kyç në përmbushjen me sukses të detyrave tona. Më lejoni të ndaj me ju disa nga arritjet kryesore të institucionit tonë.

DPPI-ja i ofron shërbimet e saj vetëm në platformën on line. Eliminimi i kohës së protokollimit dhe marrjes në dorëzim të akteve administrative pas postimit të tyre nga DPPI-ja, si dhe i qarkullimit të aplikimeve gjatë ekzaminimit, e shkurtoi ndjeshëm afatin e ekzaminimit dhe rrjedhimisht përshpejtoi marrjen e shërbimeve.

Përveç këtyre, u reduktuan masivisht edhe gabimet e shfaqura gjatë procesit të skanimit, indeksimit dhe delegimit të dokumentacionit të depozituar. Tashmë të gjitha aktet administrative të hartuara janë të digjitalizuara në sistemin SAPI dhe ekzaminuesit mund t'i aksesojnë ato në kohë reale, pa patur nevojën e konfirmimit nga protokollit.

Në Janar të vitit 2024, u prezantua një fazë e re mbi ecurinë dhe forcimin e Qendrës së Trajnimeve dhe u finalizua me sukses Strategjia e Qendrës për një periudhë 5 vjeçare 2023-2028 me qëllim ofrimin për çdo grup interesi informacione mbi fushën, të sigurojë një mjedis të përmirësuar me metodat bashkëkohore dhe të stimulojë inovacionin, shkencën dhe teknologjinë.

Në kuadër të forcimit të marrëdhënieve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, DPPI rëndësi të veçantë i ka kushtuar bashkëpunimeve me partnerët në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e pronësisë industriale me qëllim forcimin e bashkëpunimit sipas fushës së përgjegjësisë.

Pikërisht në vitin 2024, arritëm të nënshkruanim 7 marrëveshje bashkëpunimi, konkretisht me:

- Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;
- Fakultetin e Drejtësisë, Tiranë;
- Agjencinë e Start-upeve;
- Universitetin Europian të Tiranës;
- Institutin Kanadez të Teknologjisë;
- Western Balkans University;
- Kolegjin Universitar Logos;

Në lidhje me Markat Tregtare Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e Republikës së Shqipërisë (DPPI) zbaton praktikën e përbashkët Europiane CP8. DPPI publikoi një dokument praktik, në lidhje me përdorimin e markës tregtare, në një formë që ndryshon nga ajo e cila është regjistruar në mënyrë që bizneset e interesuara të njihen me praktikat e fundit të miratuara nga Zyra Europiane për Pronësinë Intelektuale.

Dokumenti, i zhvilluar në kuadër të aktiviteteve të bashkëpunimit ndërkombëtar të këtyre njësive, ka për qëllim të rrisë qartësinë, transparencën, sigurinë ligjore dhe parashikueshmërinë, në dobi të përdoruesve dhe ekzaminuesve të Zyrave të PI-së. Ky dokument, synon gjithashtu të jetë një referencë dhe për të gjitha palët e tjera të interesuara.

Një tjetër moment i rëndësishëm përgjatë këtij viti është finalizimi me sukses i programit të parë i akselerimit me fokus fuqizimin e sipërmarrjeve përmes mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale i realizuar në Shqipëri, IP4Startups! Nëpërmjet këtij programi u bë çertifikimi i 10 startup-ve fituese që për 2 muaj rresht kaluan në një trajnim intensiv për Pronësinë Industriale.

Përmirësimi i vazhdueshëm i bazës ligjore, me qëllim përafrimin me legjislacionin dhe standardet e vendeve të BE-së, vazhdon të qëndrojë në fokusin e veprimtarisë së DPPI-së.

Janë hartuar dhe përcjellë për miratim Këshillit të Ministrave 2 projektligje konkretisht “Draft Ligji për Patentat dhe Modelet e Përdorimit” dhe “Draft ligji për markat tregtare”, që do të miratohen brenda vitit 2025, gjithashtu janë dërguar për mendim në ministritë e linjës dy projektligjet për aderimin e Shqipërisë në Traktatin e Nairobit dhe atij të Singaporit.

DPPI ka vijuar politikat e saj të promovimit duke ndjekur strategji të caktuara në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit dhe të promovimit të të drejtave të pronësisë industriale, në të gjithë vendin. Janë prekur 11 qytete të Republikës së Shqipërisë, me qëllim informimin mbi objektet e PI-së dhe rëndësinë që ato kanë, për ti dhënë vlerë biznesit që ato përfaqësojnë. Në fokusin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) qëndron bashkëpunimi i ngushtë me sistemin arsimor për ndërgjegjësimin e brezave të rinj në lidhje me fushën. DPPI ka zhvilluar 11 leksione të hapura në auditoret e universiteteve të Republikës së Shqipërisë me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve mbi objektet e PI-së si dhe mënyrat e kërkimit në regjistrat europianë dhe regjistrin e Organizatës Botërore të PI-së.

Si rezultat i punës së kryer në lidhje me promovimin, DPPI e mbylli vitin 2024 me një rritje prej (742 aplikime për patenta, 35 aplikime për disenjot industriale, 1575 aplikime për marka) i cili përkthehet në shërbime më cilësore ndaj qytetarëve dhe nivele më të larta të performancës.

Më 4 dhjetor 2024 u shënuar një moment i rëndësishëm për biznesin dhe institucionet shtetërore që ofrojnë shërbime ndaj komunitetit të biznesit ku DPPI u vlerësua me “Çmimin e Institucionit më të mirë për Menaxhimin e Pronësisë Intelektuale” në kuadër të 128 vjetorit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

Në përfundim të fjalës sime, më lejoni të shpreh falënderimet e mia për të gjitha institucionet partnere, institucionet në nivel kombëtar të përfshira në sistemin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe anëtarët e grupit ndër-institucional të punës së Kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale”, përfaqësuesit e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, si dhe partnerët tanë ndërkombëtarë.


Mirënjohje të thellë, shpreh për Organizatat Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale, konkretisht: Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale, Zyrën Evropiane të Patentave dhe Zyrën e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale, të cilët kanë dhënë një kontribut të vyer për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, duke ofruar asistencën e nevojshme teknike, si dhe kanë vlerësuar performancën e institucionit tonë në të gjitha arritjet e tij.

Dhe së fundmi, por jo për nga rëndësia, dua të falënderoj veçanërisht pjesëtarët e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, të cilët me përkushtim dhe këmbëngulje arritën të përmbushin në kohë të gjitha prioritetet dhe objektivat e vendosura me herët, duke e vlerësuar si mjaft të suksesshme performancën e vitit 2024.

Me respekt,

MARIA SOLIS KAPEDANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR



QËLLIMI I VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) është institucion publik jobuxhetor me seli në Tiranë, i cili regjistron, administron dhe promovon objektet e pronësisë industriale dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë. Gjithashtu, DPPI-ja luan një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale të palët e interesuara, aktorët e përfshirë në sistem si dhe tek universitetet dhe institucionet arsimore në mbarë vendin.

STATUSI

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të PI-së.

DPPI-ja është institucioni i vetëm përmes të cilit shteti shqiptar jep të drejtat për patentat mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit, topografinë e produkteve gjysmëpërçuese, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, duke iu njohur mbajtësve të këtyre të drejtave pronësinë mbi këto objekte, nëpërmjet regjistrimit të tyre.

Gjithashtu, DPPI-ja kryen rolin e koordinatorit të Kapitullit 7, “Pronësia Intelektuale”, për të cilin raporton pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit dhe Nënkomitetit të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës, si dhe pranë Delegacionit të Bashkimit Europian, mbi ecurinë dhe aktivitetin e kryer në përmbushje të detyrimeve që i ngarkohen nga dokumentet strategjike.

MISIONI

Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale është të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet njohjes, regjistrimit dhe promovimit të të drejtave mbi objektet e Pronësisë Intelektuale, për të garantuar të njëjtin nivel mbrojtjeje me atë të vendeve të Bashkimit Europian.

FOKUSI

Në fokusin e DPPI-së është përmirësimi i funksionimit të sistemit të pronësisë industriale, me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit përmes stimulimit të punës kërkimore, veçanërisht asaj të kompanive, universiteteve dhe individëve shqiptarë, për të nxitur kështu zhvillimin ekonomik të vendit. Më specifikisht, ky sistem shërben si një mjet për të nxitur investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe për të garantuar suksesin në treg.

OBJEKTIVAT

- Sigurimi i një menaxhimi dhe koordinimi të brendshëm dhe më gjerë, për të përmirësuar mbrojtjen dhe zbatimin e pronësinë intelektuale në mbarë botën;
- Arritja e një organizimi të shkëlqyer për forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Tejkalimi me sukses i sfidave për implementimin e synimeve, objektivave dhe iniciativave të ndërmarra në “Strategjinë e Re Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025”.

TË DHËNA STATISTIKORE PËR OBJEKTET E PRONËSISË INDUSTRIALE

Drejtoria e Ekzaminimit

Si një ndër strukturat më të rëndësishme të DPPI-së, ka si detyrë funksionale regjistrimin e objekteve të PI-së, administrimin e regjistrave të këtyre objekteve, përgatitjen dhe publikimin e buletinëve të PI-së si dhe informimin e publikut në lidhje me procedurat e regjistrimit të objekteve të PI-së në vend. Drejtoria e Ekzaminimit, si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, ka në përbërje të saj 15 punonjës, të cilët janë të strukturuar në 3 sektorë dhe ka si detyrë funksionale regjistrimin e objekteve të PI-së, si dhe administrimin e regjistrave të këtyre objekteve. Konkretisht:

1. Sektori i Pritjes dhe Informacionit, i cili ka në përbërje të tij 3 punonjës dhe ka si detyrë kryesore pritjen e aplikimeve për regjistrim dhe mirëmbajtje, publikimin dhe dhënien e informacionit në lidhje me objektet e PI-së.
2. Sektori i Patentave dhe Modeleve të Përdorimit, i cili ka në përbërje të tij 4 punonjës dhe ka si detyrë kryesore ekzaminimin e aplikimeve për patenta dhe modele përdorimi, si dhe administrimin e regjistrave për këto objekte.
3. Sektori i Markave, Disenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografikë, i cili ka 7 punonjës në përbërje të tij dhe ka si detyrë kryesore ekzaminimin e aplikimeve për marka, disenjo industriale, tregues gjeografikë dhe emërtime të origjinës, si dhe administrimin e regjistrave për këto objekte.


Sektori i Markave, Disenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografikë

Sektori i Markave, Disenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografikë është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Ekzaminimit dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në regjistrimin e markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, si dhe administrimin e regjistrave të këtyre objekteve. Veprimtaria e këtij sektori konsiston në zbatimin e procedurave të ekzaminimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Aplikime për regjistrim marke:

Përgjatë vitit 2024 janë paraqitur për regjistrim marke 1575 aplikime pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, kurse gjatë vitit 2023 janë paraqitur për regjistrim marke në total 1311 aplikime, në vitin 2022 janë paraqitur 1165 aplikime dhe në vitin 2021 janë paraqitur 1404.

Pra, vihet re një rritje e konsiderueshme e numrit të aplikimeve për regjistrim marke prej 16.8 %, sipas grafikut të mëposhtëm:



Aplikime për regjistrim marke nga Marrëveshja e Madridit (markat ndërkombëtare)

Marrëveshja e Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave (1891) është një traktat ndërkombëtar i menaxhuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO). Ajo mundëson regjistrimin e markave në shumë shtete përmes një procedure të vetme dhe një aplikimi ndërkombëtar. Kjo sistematizon dhe thjeshton regjistrimin e markave për subjektet që dëshirojnë të mbrojnë markën e tyre në shumë shtete.

Kjo marrëveshje është një mjet i rëndësishëm për bizneset që kërkojnë të zgjasin mbrojtjen e markave të tyre në tregje të ndryshme dhe të shmangin kompleksitetet e regjistrimeve të veçanta për çdo vend. Protokollin e Madridit (i miratuar në vitin 1989) është një dokument që ka për qëllim të modernizojë dhe të përmirësojë sistemin e Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave. Protokollin është një shtesë dhe një alternativë që e bën regjistrimin ndërkombëtar më të thjeshtë dhe më fleksibël për shumë shtete.


Shqipëria ka aderuar në Marrëveshjen e Madridit më 1 shtator 1993 dhe më pas ka aderuar gjithashtu në Protokollin e Madridit më 25 mars 2008.

Kjo do të thotë që aplikantët shqiptarë mund të përfitojnë nga mundësitë e ofruara nga të dyja sistemet për regjistrimin e markave ndërkombëtare, si dhe mund të kërkojnë mbrojtje në shtetet që janë pjesë e këtyre marrëveshjeve.

Gjatë vitit 2024 për shtrirjen e mbrojtjes për Republikën e Shqipërisë ishin në total 2677 aplikime ndërkombëtare, për vitin 2023 ishin 2954 aplikime, për vitin 2022 ishin në total 2017 aplikime dhe për vitin 2021 ishin gjithsej 1741 aplikime për regjistrim marke nga Marrëveshja e Madridit.

Për sa u përket certifikatave të regjistrimit për markat, përgjatë vitit 2024, DPPI ka lëshuar 1.020 certifikata regjistrimi, në vitin 2023 janë lëshuar 1.311 certifikata regjistrimi, në vitin 2022 janë

lëshuar 963 certifikata regjistrimi dhe në vitin 2021 janë lëshuar 1.245 certifikata regjistrimi për markat tregtare.



Ajo që vihet re nga grafikët e mësipërm është trendi në rritje për regjistrimet ndërkombëtare të cilat kërkojnë të shtrijnë mbrojtjen edhe për Shqipërinë.

Certifikata regjistrimi të lëshuara nga DPPI


Për sa u përket certifikatave të regjistrimit për markat, përgjatë vitit 2024 DPPI-ja ka lëshuar 1020 certifikata regjistrimi, në vitin 2023 janë lëshuar 1087 certifikata regjistrimi, në vitin 2022 janë lëshuar 963 certifikata regjistrimi dhe në vitin 2021 janë lëshuar 1245 certifikata regjistrimi për markat tregtare.



Aplikime për ripërtëritje marke:

Marka mund të ripërtërihet pafundësisht për periudha dhjetëvjeçare, pasi pronari depoziton një kërkesë për këtë qëllim në DPPI dhe paguan tarifën përkatëse.


Përgjatë vitit 2024 janë paraqitur 569 aplikime për ripërtëritje marke, në vitin 2023 numri i aplikimeve ishte në total 485, në vitin 2022 numri i aplikimeve ishte 535 dhe në vitin 2021 numri i aplikimeve për ripërtëritje marke ishte 521.



Siç duket edhe nga tabela krahasimore më sipër, vihet re një rritje prej afërsisht 15 % e aplikimeve për ripërtëritjen e markave të regjistruara për një periudhë shtesë prej 10 vjetësh.

Aplikime për regjistrim Treguesi Gjeografik/ Emërtime Origjine

Për sa u përket aplikimeve për regjistrim Treguesi Gjeografik/ Emërtime Origjine, pranë DPPI-së janë paraqitur në vitin 2024 në total 2 aplikime, në vitin 2023 janë paraqitur 3 aplikime, në vitin 2022 është paraqitur 1 aplikim dhe në vitin 2021 është paraqitur po ashtu vetëm 1 aplikim për regjistrim Treguesi Gjeografik/ Emërtime Origjine.




Numri i Treguesit Gjeografik/ Emërtim i Origjinës të cilët janë regjistruar deri më tani është 22 nga 30 kërkesa aplikimi të depozituara në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë. Gjatë viteve të fundit, vihet re një trend në rritje i aplikimeve për regjistrim TGJ/ EO nga aplikantët shqiptarë.

Disenjt Industrialë në Republikën e Shqipërisë

Në Republikën e Shqipërisë, Disenjt Industrialë mbrohen nëpërmjet regjistrimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, e cila zbaton të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e tyre, si dhe nëpërmjet sistemit të Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të tyre.


Marrëveshja e Hagës është një traktat ndërkombëtar që mundëson regjistrimin e Disenjove Industriale në një nivel global përmes një procedure të thjeshtë dhe të centralizuar. Ky sistem menaxhohet nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe u krijua për të ofruar mbrojtje për disenjon industriale në shumë shtete me një aplikim të vetëm.

Përgjatë vitit 2024 në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë paraqitur në total 35 aplikime për regjistrimin e disenjove industriale, kurse në vitin 2023 janë paraqitur 38, në vitin 2022 janë paraqitur 19 dhe në vitin 2021 janë paraqitur 49 aplikime për regjistrim Disenjoje Industriale sipas tabelës së mëposhtme:



Ndërkohë, për sa u përket aplikimeve për ripërtëritjen e Disenjove Industriale të mbrojtur, përgjatë vitit 2024 janë paraqitur 3 aplikime në total, në vitin 2023 janë paraqitur 5 aplikime, në vitin 2022 janë paraqitur 7 aplikime dhe në vitin 2021 janë paraqitur 4 aplikime për ripërtëritjen e Disnjëve Industriale.

Regjistrimi i Disenjove Industriale mund të ripërtërihet kundrejt një pagese të caktuar për një periudhë shtesë prej pesë vjetësh, deri në një periudhë prej 25 vjetësh.



DHOMA PËR SHQYRTIMIN E KUNDËRSHTIMEVE


Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve është krijuar në bazë të nenit 193, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar, e cila ka si objekt të veprimtarisë së saj shqyrtimin e kërkesave për kundërshtim dhe observim.

Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve është një strukturë e ngritur brenda njësisë së ekzaminimit dhe ka në përbërje të saj 3 anëtarë të kësaj njësie, të emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Kjo dhomë ka filluar të funksionojë pas hyrjes në fuqi në datën 06.06.2018 të VKM nr. 315, datë 31.5.2018 “Për miratimin e rregullore për markat”, që parashikon procedurën administrative për shqyrtimin e kërkesave drejtuar kësaj dhome.

Përgjatë vitit 2024 janë depozituar 71 kërkesa për kundërshtimin e dhënies së pronësisë industriale, ndër të cilat 2 aplikime për kundërshtimin e disenjos industriale të publikuar dhe 69 kërkesa për kundërshtimin e markës së publikuar, për të cilat është vendosur si më poshtë:

- Vendim për pranimin e plotë të kërkesës për kundërshtim - 9 vendime;
- Vendim për rrëzimin e kërkesës për kundërshtim - 1 vendim;
- Vendim për refuzimin e kërkesës për kundërshtim - 15 vendime;
- Njoftim për pezullimin e procedurës së kundërshtimit - 3 njoftime;
- Pranim i dorëheqjes nga kërkesa për kundërshtim - 3 njoftime;
- Vendim për pranimin e plotë të kërkesës për kundërshtim për disenjo industriale - 1 vendim;
- Vendim për refuzimin e kundërshtimit për disenjo industriale - 1 vendim;
- Në proces kundërshtimi - 38 aplikime, për të cilat është lëshuar “Njoftim për plotësim të metash në kërkesën për kundërshtim” dhe “Njoftim për pjesëmarrje në procedurë kundërshtimi”.



PATENTAT PËR SHPIKJE DHE MODELET E PËRDORIMIT

Sektori i Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit ka si detyrë funksionale regjistrimin e aplikimeve të objekteve të Pronësisë Industriale, si patentat për shpikje dhe modelet e përdorimit, si dhe administrimin e regjistrave të këtyre objekteve.

REALIZIMET

Për periudhën 01/01/2024 deri 31/12/2024 Sektori i Patentave dhe Modeleve të Përdorimit ka realizuar detyrat e mëposhtme:

- I. **Objektivi kryesor** i punës së Sektorit të Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit është ekzaminimi i objekteve të Pronësisë Industriale në mbështetje të Ligjit 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, që do të vazhdojë me përparësi në funksion të rritjes së cilësisë së ekzaminimit duke mundësuar rritjen e numrit të dokumenteve të lëshuara.
 - Sektori i Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit ka kryer me përparësi të gjitha hallkat e procesit të ekzaminimit të objekteve të PI-së, në të gjitha hapat që duhet të ndiqen për aplikimet që nga ekzaminimi formal deri te faza e lëshimit të certifikatës.

TË DHËNA STATISTIKORE PËR VITIN 2024

Sektori i Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit ka si detyrë funksionale regjistrimin e aplikimeve të objekteve të Pronësisë Industriale, si patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit, si dhe administrimin e regjistrave të këtyre objekteve. Ky sektor gjatë këtij viti ka përballuar një volum të madh pune dhe ka realizuar të gjitha detyrat e ngarkuara në kohë dhe me cilësi.

Gjatë vitit 2022, Sektori i Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit ka pasur **742 aplikime për patenta, nga të cilat 12 janë aplikim për patentë kombëtare** me aplikantë shtetas shqiptarë dhe **730 aplikime për patenta** janë patenta të lëshuara nga Zyra Europiane e Patentave, të cilat kërkojnë mbrojtje në Shqipëri.

APLIKIME PËR PATENTA

APLIKIME	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Aplikime për patentë kombëtare	5	12	23	20	9	12
Patenta nga Zyra Europiane e Patentave	908	885	923	601	658	730
Aplikime nga Traktati i Bashkëpunimit	0	1	2	0	3	0
Aplikime për certifikatë të mbrojtjes shtesë	0	1	3	4	4	11
TOTALI Patenta	913	898	948	621	667	742

Tabela 1. Aplikime për patenta kombëtare

Aplikimet kombëtare janë kryesisht të fushave:

- 2 patenta janë të fushës mekanike
- 2 patenta janë në fushën teknologji ushqimore

8 patenta janë të fushës së artikujve personalë/ shtëpiakë (nevoja njerëzore)




Tabela 2. Aplikime për patenta europiane

Aplikime për shtrirje/ njohje të vlefshmërisë së patentave europiane





Tabela 3. Aplikime për patenta në vite

Grafiku i mëposhtëm tregon trendin e aplikimeve për patenta, të depozituara në vite.




APLIKIME PËR MODELE PËRDORIMI

Gjatë periudhës **janar-dhjetor 2024** janë depozituar **4 aplikime** për regjistrim të modeleve të përdorimit, ndërkohë që për periudhën **janar-dhjetor 2023** ka pasur **3 aplikime për model përdorimi**.

Aplikime për model përdorimi

APLIKIME	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Aplikime për model përdorimi	1	2	3	3	3	4

Tabela 4. Aplikime për modele përdorimi



STATISTIKA TË EKZAMINIMIT TË PATENTAVE

PATENTA PËR SHPIKJE	Janar – dhjetor 2022	Janar- dhjetor 2023	Janar- dhjetor 2024
Kërkesa për regjistrimin e patentave kombëtare	20	9	12
Patenta kombëtare të regjistruara/ refuzuara	4/17	10	13/
Kërkesa për vlefshmëri të patentave nga EPO	601	658	730
Patenta të validuara/ refuzuara	629/22	557/5	808/40
Kërkesa për regjistrimin e Certifikatës së mbrojtjes shtesë (SPC)	4	4	11
Certifikata të mbrojtjes shtesë (SPC) të regjistruara	4	6	7
Kërkesa për ripërtëritjen patentës	4873	5239	5153
Patenta të ripërtërira/ refuzuara	5527	3766	5279/232
Kërkesa për ndryshime në regjistrin e patentave (# emër+ #adresë + #pronësi + # pretendime)	194	315	183
Ndryshime në regjistër të pranuar	156	267	173
Kërkesa për rivendosje në afat të patentës	6	3	11
Rivendosje në afat të pranuar/ refuzuara	10/5	3/1	10/1
Dokumente në total të depozituara çështje në lidhje me patentat	6464		
Dokumente në total të lëshuara nga Sektori i Patentave	6845	6762	7959

1. Akte administrative të nxjerra nga Sektori i Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit

Gjatë vitit **2024** Sektori i Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit ka lëshuar **gjithsej 7959** akte administrative për patentat, modelet e përdorimit dhe ndryshimet në regjistër lidhur me to.

Sektori i Patentave ka përgatitur 22 **Memo për Sektorin e Financës** lidhur me kërkesat për rimbushime të pagesave të ndryshme të kryera lidhur me patentat.

Tabela e mëposhtme tregon kërkesat si dhe aktet e lëshuara nga DPPI-ja gjatë periudhës janar-dhjetor 2023-2024

PATENTA PËR SHPIKJE	Janar-dhjetor 2023	Janar-dhjetor 2024
Totali i kërkesave për regjistrimin e patentave	667	742
Kërkesa për regjistrimin e patentave europiane (vlefshmëri/ shtrirje)	658	730
Numri i patentave të regjistruara	557	808
Kërkesa për regjistrimin e patentave kombëtare	9	12
Patenta kombëtare të regjistruara	10	13
Aplikime për certifikatë të mbrojtjes shtesë	4	11
Certifikata të mbrojtjes shtesë (SPC) të regjistruara	6	7
Aplikime për modele përdorimi	3	4
Modele përdorimi të regjistruara	4	1
Kërkesa për ripërtëritjen e patentës	5239	5153
Ripërtëritjet e patentave të shqyrtuara	3766	5511
Kërkesa për ndryshime në regjistrin e patentave	316	183
Ndryshime në regjistrin e patentave	267	173
Kërkesa për rivendosje në afat të patentës	4	11
Rivendosje në afat të shqyrtuara	4	12
Aplikime për patentë të refuzuara	5	40
Patenta të skaduara	17	1029
Korrigjime të gabimeve	64	56
Kërkesa për shtyrje afati		35
Njoftime gjatë procesit të ekzaminimit		254
Dokumente në total të depozituara për çështje në lidhje me patentat		15949
Dokumente në total të lëshuara nga Sektori i Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit	6762	7959

REALIZIMET

- Objektivi kryesor** i Drejtorisë së Ekzaminimit është rritja e cilësisë së shërbimeve nëpërmjet respektimit të afateve dhe procedurave të ekzaminimit sipas standardeve bashkëkohore për mbrojtjen e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

Të gjitha aplikimet në lidhje me objektet e PI-së aplikohen nëpërmjet platformës e-Albania dhe i gjithë procesi i ekzaminimit kryhet dhe menaxhohet online nëpërmjet sistemit SAPI, që prej datës 31 korrik 2023.

Objektivi kryesor i Drejtorisë së Ekzaminimit është rritja e cilësisë në ekzaminim, duke respektuar afatet e parashikuara dhe standardizimin e procesit të ekzaminimit të objekteve të pronësisë industriale.

Në kuadër të objektivave të mësipërm, janë realizuar arritjet si më poshtë:

- Përgjatë vitit 2024 janë ekzaminuar me cilësi në mbështetje të legjislacionit për Pronësinë Industriale dhe brenda afateve ligjore të gjitha aplikimet për objektet e PI-së drejtuar për shqyrtim sektorëve përkatës të Drejtorisë së Ekzaminimit;
- ✓ Është trajnuar stafi i kësaj drejtorie nga ekspertët e organizatave ndërkombëtare europiane dhe botërore (WIPO) për standardizimin e procedurave të ekzaminimit dhe unifikimin e vendimmarrjeve, sipas praktikave më të mira të përbashkëta;
- ✓ Është trajnuar stafi i ri nga punonjësit me më shumë eksperiencë të DPPI-së;
- ✓ Është trajnuar stafi për standardizimin e procedurave të ekzaminimit, në mënyrë që për çështje të ngjashme të shmangen qëndrimet e ndryshme në aktet administrative;
- ✓ Është hartuar Manuali i Certifikatave të Mbrojtjes Shtesë në ndihmë të punonjësve të Drejtorisë së Ekzaminimit, duke unifikuar praktikat e ekzaminimit.
- Drejtorja e Ekzaminimit luan rol kryesor në identifikimin dhe adresimin e problematikave të hasura në konfigurimin e Sistemit të Administrimit të Pronësisë Industriale (SAPI).

Objektivi 2. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në vend në funksion të mbrojtjes së objekteve të PI-së.

- Lidhur me këtë objektiv është forcuar më tej bashkëpunimi ndërinstitucional kombëtar në fushën e zbatimit dhe mbrojtjes së PI-së. Drejtorja e Ekzaminimit në këtë aspekt ka një kontribut të rëndësishëm në procesin e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacioneve të nevojshme ndërmjet institucioneve ligjzbatuese në fushën e PI-së, siç janë: DPD, ISHMT, DDA, Policia e Krimit Financiar dhe organet gjyqësore të të gjitha niveleve.

Objektivi 3. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me organizatat ndërkombëtare të fushës në funksion të mbrojtjes ndërkombëtare të objekteve të PI-së.

- Drejtorja e Ekzaminimit ka bashkëpunuar me institucionet ndërkombëtare WIPO dhe EPO në të cilat Republika e Shqipërisë është vend anëtar, si dhe me EUIPO ku Republika e Shqipërisë ka statusin e shtetit vëzhgues. Kjo ka sjellë si pasojë zbatimin me cilësi dhe në kohë të detyrimeve që lindin nga marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe përmirësimin e ekzaminimit të aplikimeve për regjistrim ndërkombëtar të objekteve të PI-së. Shkëmbimi i të dhënave në lidhje me regjistrimet ndërkombëtare të objekteve të PI-së (WIPO, EPO) dhe detyrimeve ligjore që lindin nga këto veprime në lidhje me këto objekte janë kryer në kohë dhe me cilësi.

Objektivi 4. Përmirësimi i kuadrit ligjor.

- Drejtorja e Ekzaminimit ka luajtur rol aktiv si pjesë e grupit të punës për realizimin e një prej objektivave më të rëndësishëm të DPPI-së për vitin 2024, që është përmirësimi i kuadrit ligjor. Koncretisht, është dhënë kontribut i rëndësishëm lidhur me: draft-ligjin për Markat, draft-ligjin për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë, rregulloren e funksionimit të DPPI-së dhe rregulloren e funksionimit të sistemit SAPI.

II. Aktivitete të tjera promovuese dhe informuese për patentat

Drejtorja e Ekzaminimit ka qenë përgjatë gjithë vitit 2024, sa herë është kërkuar, pjesë e grupeve trajnuese në aktivitetet e ndryshme trajnuese të publikut, bizneseve, studentëve etj., në lidhje me ndërgjegjësimin e subjekteve në fushën e PI-së, të zhvilluara nga DPPI-ja.

Pjesëmarrje dhe aktivitete të organizuara nga drejtoria si dhe organizma të tjerë me të cilët DPPI-ja bashkëpunon.

Kemi marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga EPO Academy, të cilat përgjatë gjithë vitit 2024 janë zhvilluar online si pasojë e pandemisë botërore dhe kufizimeve të lëvizjeve.

- Në kuadër të bashkëpunimit me EPO, studenti i Universitetit Politeknik të Tiranës ka ndjekur internshipin e ofruar nga EPO në bashkëpunim me DPPI-në pranë Sektorit të Patentave në periudhën janar-shkurt 2024.
- Trajnime për stafin e ri nga punonjësit me më shumë eksperiencë të DPPI-së për standardizimin e procedurave të ekzaminimit.
- Trajnime për stafin dhe përfaqësuesit e autorizuar në lidhje me klasifikimin e patentave si dhe pretendimet e patentave.
- Vizitë studimore në Bernë në datat 7-12 prill, në kuadër të projektit shqiptaro-zviceran në fushën e Pronësisë Intelektuale (ALSIP).
- Në vijim të zbatimit të kalendarit të miratuar nga MEKI, DPPI në takimet me biznesin në kuadër të fushatës ndërgjegjëse për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale, u zhvilluan takime me biznesin në zonën e Sarandës në datat 2–4 tetor 2024 dhe në zonën Himarë-Dhërmi në datat 6-8 nëntor 2024.
- Panairi “Future2Tech” - 9-10 tetor 2024. Një panair dyditor dedikuar inovacionit, teknologjisë, edukimit dhe investimeve. Përfaqësues të sektorit të patentave kanë marrë pjesë aktivisht në stendën e DPPI-së duke dhënë informacione të vlefshme për të gjithë pjesëmarrësit dhe të interesuarit për fushën e Pronësisë Industriale dhe sidomos për rëndësinë, përfitimet dhe procedurat e aplikimit për mbrojtjen e shpikjeve nëpërmjet patentave dhe modeleve të përdorimit. Ky panair konsiderohet si një mundësi shumë e mirë për të promovuar objektet e Pronësisë Industriale dhe për të pasur një kontakt më të drejtpërdrejtë me ekspozuesit e ideve inovatore të pranishëm në këtë panair.
- Programi për trajnimin e startup-ve për Pronësinë Industriale “IP4STARTUP”, 1 gusht-21 tetor 2024. Një program akselerimi përshtatur për nevojat specifike të startup-eve inovative. Për të mbështetur idetë inovatore të startup-eve të përzgjedhura, përfaqësues të Sektorit të Patentave kanë ofruar trajnime mbi tematikat që lidhen me rëndësinë e mbrojtjes së shpikjeve nëpërmjet patentave dhe modeleve të përdorimit, procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të tyre në DPPI, të drejtat e pronësisë në marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës si dhe licensat për patentat.
- Pjesëmarrje në workshop-in me temë **“WIPO Assessment Mission on the Current Status of Technology Transfer (TT) Systems in Albania and North Macedonia, and Awareness-Raising”** nga ekspertë të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) - **5 nëntor 2024**.
- Workshop mbi Pronësinë Intelektuale me startup-et në kuadër të Marrëveshjes me Agjencinë e Startupeve – 10 shtator 2024 – vazhdim. Në kuadër të marrëveshjes që DPPI-ja ka me Agjencinë e Startupeve dhe workshop-eve të organizuar për këtë qëllim, përfaqësues të Sektorit të Patentave kanë bërë prezantimet e tyre mbi mbrojtjen e shpikjeve nëpërmjet patentave dhe modeleve të përdorimit në Republikën e Shqipërisë, kushtet dhe procedurat e regjistrimit.
- Panairi “Shije dhe traditë” – 16 nëntor 2024, Peshkopi. Përfaqësues nga Sektori i Patentave ndoqën takimin informues të dedikuar prodhuesve dhe fermerëve të qarkut të Dibrës për identifikimin e produkteve me potencial të mundshëm regjistrimi si Tregues Gjeografikë.

Trajnime dhe kualifikime:

I. Kemi marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga EPO Academy, të cilat përgjatë gjithë vitit 2024 janë zhvilluar online, si pasojë e pandemisë botërore dhe kufizimeve të lëvizjeve.

Nr.	Data	Tema të zhvilluara nga EPO Academy dhe WIPO
1	22 janar–1 mars 2024	Tutored self-paced course on patentability criteria and clarity
2	22 shkurt–25 prill 2024	Patenting seminar series on artificial intelligence and applied fields
3	4 mars–12 prill 2024	Tutored programme on clarity and non-unity
4	30 prill 2024	Update on recent decisions of the Boards of Appeal
5	2 maj–28 qershor 2024	The ANSERA-based SEARCH tool for experienced users
6	3 qershor–5 korrik 2024	Novelty and inventive step
7	1 tetor 2024	Computer implemented inventions
8	8 tetor 2024	iLearn Together
9	15 maj 2024–31 janar 2025	WIPO Pilot Project for Needs-Assessment, Network Building, and Capacity Building of Patent Examiners in the Central European and Baltic States and Mediterranean Countries (CEBSMC)
10	30 shtator–4 tetor 2024	Trade and Public Health Workshop, WHO and WIPO Secretariats
11	14-18 tetor 2024	Standing Committee on the Law of Patents: Thirty-Sixth Session WIPO
12	5 nëntor 2024	WIPO Assessment Mission on the Current Status of Technology Transfer (TT) Systems in Albania and North Macedonia, and Awareness-Raising Workshop, WIPO dhe mbështetjen e ASCAL;
13	29 nëntor 2024	Intergovernmental Committee on Intellectual Property and Genetic Resources, Traditional Knowledge and Folklore: Forty-eighth Session– WIPO;
14	2-6 dhjetor 2024	Intergovernmental Committee on Intellectual Property and Genetic Resources, Traditional Knowledge and Folklore: Forty-ninth session, WIPO;

Sektori i Pritjes dhe i Informacionit

Gjatë vitit 2024 objektivat kryesorë të Sektorit të Pritjes dhe të Informacionit në kuadrin e Drejtorisë së Ekzaminimit në DPPI kanë qenë:

1. Pjesëmarrja aktive në veprimtarinë ligjore të Sektorit të Pritjes dhe të Informacionit, duke zbatuar dhe duke përmbushur detyrat ligjore në afat;
2. Pjesëmarrja direkte në rritjen e cilësisë dhe në respektimin e afateve të ekzaminimit të kërkesave të depozituara lidhur me objektet e PI-së, në mbështetje të Ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për pronësinë industriale, i ndryshuar;
3. Kontrolli periodik i realizimit të detyrimeve ligjore nga specialistët e sektorit;
4. Rritja e cilësisë së hartimit të buletinit të Pronësisë Industriale;
5. Pjesëmarrja aktive në promovimin e PI-së në mbarë Republikën e Shqipërisë;
6. Përgatitja e raporteve dhe materialeve të tjera lidhur me veprimtarinë e Sektorit dhe pjesëmarrja aktive në procesin e hartimit të planeve strategjike të institucionit, përmirësimeve ligjore për objektet e PI-së;
7. Mirëmbajtja, administrimi dhe përpunimi i arkivit të objekteve të PI-së;
8. Ekzaminimi në afat dhe me cilësi i aplikimeve ndërkombëtare lidhur me njohjen e të drejtave të objekteve të PI-së;
9. Dhënia e informacionit zyrtar të kërkuar nga publiku në kohë sa më të shkurtër, me etikë dhe me profesionalizëm;
10. Kryerja në kohë e procedurave të organeve kolegjiale, ku punonjësit e sektorit të pritjes dhe informacionit kanë funksione si anëtarë, siç është rasti i dhomës për shqyrtimin e kundërshtimeve, si dhe çdo organi tjetër apo komisioni në DPPI;
11. Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të sektorit nëpërmjet njohjes dhe studimit të akteve ligjore e nënligjore të fushës së PI-së dhe diskutimit profesional mbi çështjet e PI-së;
12. Pjesëmarrja aktive në GNPIE.

Objektivat janë përmbushur duke realizuar detyrat funksionale të sektorit, të cilat për vitin 2024 kanë qenë:

- Pritja (në sistemin SAPI) e të gjitha kërkesave që lidhen me regjistrimin e objekteve të PI-së dhe kryerja e veprimeve të para të procedurës së ekzaminimit të aplikimeve për regjistrimin e objekteve të PI-së, që është njohja e datës së depozitimit nëpërmjet lëshimit të dëshmisë së depozitimit, e cila përbën një nocion/ akt juridik me rëndësi parësore, pasi lidhet me njohjen ligjore të momentit nga i cili nisnin për subjektet të drejtat ligjore mbi objektet e PI-së.
- Përpunimi elektronik, digjitalizimi dhe përcjellja elektronike për ekzaminim të mëtejshëm në sektorët përkatës të Drejtorisë së Ekzaminimit i të gjitha dokumenteve shkresore plotësuese të mbërritura në DPPI me postë fizike, që kanë të bëjnë me dokumente të nevojshme provuese lidhur me mbrojtjen e të drejtave mbi objektet e PI-së;
- Lëshimi i dublikatave, informacioneve, ekstrakteve nga baza kombëtare elektronike e të dhënave të PI-së;
- Ekzaminimi dhe përcjellja në zyrat ndërkombëtare e aplikimeve që lidhen me regjistrimin ndërkombëtar të objekteve të PI-së;
- Informimi verbal dhe me mjete elektronike i publikut në lidhje me procedurat e veprimeve që kryen sektori i ekzaminimit në lidhje me objektet e PI-së;
- Administrimi, mirëmbajtja dhe përpunimi periodik i vazhdueshëm i arkivit shkresor të objekteve të PI-së në DPPI etj.

- Sektori i Pritjes dhe i Informacionit ka kontribuar aktivisht gjatë vitit 2024 duke bashkëpunuar në përmirësimin e vazhdueshëm të anës përmbajtjesore dhe të formës (konfigurimit) të sistemit kompjuterik të punës për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale që shënoi një hop cilësor në punën e institucionit;
- Sektori i Pritjes dhe i Informacionit ka kryer edhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët.

Sektori i Pritjes dhe i Informacionit, për arritjen e qëllimit të zbatimit të detyrave funksionale, ka realizuar, ndër të tjera, shifrat si vijon:

Ka ekzaminuar dhe ka përfunduar me akt administrativ procedurat e iniciuara me 6967 kërkesa, të cilat konsistojnë në:

- 1562 kërkesa për regjistrim të markave kombëtare;
 - 12 kërkesa për patenta për shpikje;
 - 4 kërkesa për modele përdorimi;
 - 35 kërkesa për regjistrim të disenjove industriale;
 - 2 kërkesa për regjistrim të treguesve gjeografikë;
 - 1174 hetime për objekte të PI-së;
 - 7 kërkesa për dublikata;
 - 21 kërkesa për inspektime;
 - 121 kërkesa për ekstrakte nga regjistri i PI-së;
 - 29 aplikime për regjistrime ndërkombëtare të objekteve të PI-së.
-

- **Ka publikuar:**
34 buletinë të Pronësisë Industriale.
- **Ka pritur, procesuar, digjitalizuar, reflektuar në sistem dhe ka përcjellë për ndjekje në sektorët:**
Rreth 5021 dokumente plotësuese.
- **Ka informuar nëpërmjet postës elektronike publikun me:**
1113 e-mail-e informuese
info@dppi.gov.al
nëpërmjet nr. të gjelbër
08001993.
- **Puna e kryer në arkivin e patentave me njësi:**
Veçimi, matja, transportimi dhe sistemimi i dokumentacionit të periudhës 1994-2010 dhe periudhës 2010 e në vazhdim.
- **Puna e kryer në arkivin e markave me njësi:**
 - Marrje në dorëzim me procesverbal: 1499 dosje.
 - Plotësime: 2638 fletë indeksi.
 - Renditje sipas numrit rendor dhe shpërndarje në kutitë përfundimtare të arkivimit: 11230 dosje.
- **Lidhur me punën me arkivin e objekteve të PI-së janë realizuar, ndër të tjera, edhe:**
Përgatitja e dokumentacionit për asgjësimin e dokumenteve të arkivit që kanë kaluar afatin e ruajtjes për vitin 2024, që përfshin:
 - Matja e vëllimit të dokumentacionit për arkivin e patentave/ markave.
 - Pjesëmarrje në takimet me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, me qëllim asgjësimin e dokumentacionit për vitin 2013.
 - Përgatitje e dokumentacionit ligjor për asgjësimin e dokumentacionit të parashikuar për vitin 2013.

VEPRIMTARIA E KOORDINIMIT DHE E PROMOVIMIT TË AKTIVITETEVE NDËRGJEGJËSUESE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE, ME TË GJITHA GRUPET E INTERESIT

Drejtoria e Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës

Drejtoria e Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës është një strukturë me rëndësi të veçantë për sa i përket rritjes së ndërgjegjësimit për regjistrimin dhe mbrojtjen e objekteve të Pronës Industriale. Kjo drejtori përbëhet nga dy sektorë, Sektori i Koordinimit, Raportimeve dhe Analizës (4 punonjës) dhe Sektori i Promovimit dhe Qendra e Trajnimeve (4 punonjës).

Roli i Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës është të promovojë në nivel kombëtar Pronësinë Industriale dhe të mbrojë subjektet e interesuara nga falsifikimi dhe kopjimi i mallrave e shërbimeve.

Në këtë kuadër, janë përgatitur dhe shpërndarë materiale informuese mbi pronësinë industriale, si video, libra, broshura, artikuj për rrjetet sociale dhe faqen zyrtare të DPPI-së.

Janë ndërmarrë bashkëpunime teknike në formën e marrëveshjeve dypalëshe, në fushën e Pronësisë Industriale, me zyrat homologe rajonale dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale për ngritjen e Qendrave të Informacionit Teknik Shkencor (QITSH) për bashkëpunime të mëtejshme.

Ndërkaq, DPPI-ja vijon koordinimin e punës me organizatat ndërkombëtare WIPO, EPO dhe EUIPO, sipas marrëveshjeve teknike në fuqi. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve të suksesshme, është mundësuar ofrimi i shërbimeve të reja dhe është përfituar një asistencë e lartë teknike dhe profesionale, duke rritur ndjeshëm në këtë mënyrë kapacitetet administrative dhe institucionale, si dhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

AKTIVITETET KRYESORE TË VITIT 2024

11 mars 2024 - Workshop “Building Respect for Intellectual Property for Judges, Prosecutors and Law Enforcement Officials”



Në kuadër të projektit shqiptaro-zviceran (ALSIP) në fushën e Pronësisë Intelektuale, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale organizoi workshop-in me temë “Building Respect for Intellectual Property for Judges, Prosecutors and Law Enforcement Officials”, ku kishim kënaqësinë të kishim të pranishme edhe znj. Olga Alleman, përfaqësuese e projektit ALSIP.

Ky aktivitet organizohet në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës, ku vlen të theksohet se bashkëpunimin midis institucioneve është për t’u vlerësuar.

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe prezantimit të koncepteve të Inteligjencës Artificiale, Metaverse, si ndikon në fushën e Pronësisë Intelektuale dhe në respektimin e të drejtave të autorit.

20 qershor 2024 - Konferenca me temë “Pronësia intelektuale dhe inovacioni - Shqipëria dhe rruga drejt Bashkimit Europian”

Në bashkëpunim të ngushtë me partnerët kryesorë të ICC Albania, Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Francë-Shqipëri, si dhe me mbështetjen e projektit shqiptaro-zviceran në fushën e Pronësisë Intelektuale ALSIP dhe projektit “Saneca II/GIZ Albania”.

Qëllimi i kësaj konference ishte që palë të ndryshme interesi të ndajnë njohuri dhe eksperiencë, sfida dhe mundësi që lidhen me të drejtat, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e Pronësisë Intelektuale në sektorë, si teknologjia, inovacioni, farmaceutika dhe treguesit gjeografikë.

Në fjalën e saj, Drejtori i ri i Përgjithshëm i Pronësisë Industriale, znj. Maria Solis, theksoi rolin promotor të DPPI-së, reformën ligjore, hapat që po ndiqen për përafrimin e legjislacionit me direktivat e BE-së në fushën e Pronësisë Industriale, Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025 - si dokumenti më i rëndësishëm strategjik, aktivitetet dhe iniciativat e shumta të ndërmarra në fushën e PI-së.

Aktiviteti u përshëndet nga zëvendësministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Endrit Yzeiraj, i cili theksoi se Qeveria Shqiptare i ka dhënë një rëndësi të veçantë Pronësisë Intelektuale, për vetë kontributin që politikat për Pronësinë Industriale japin në zhvillimin e vendit, gjithashtu një nga kapitujt me rëndësi në procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Europian ka të bëjë me Pronësinë Intelektuale. Pjesë e panelit ishte zëvendëshefi i Misionit të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, Z. Philip Arnold, i cili është një nga partnerët kryesorë mbështetës në këtë fushë përmes projektit ALSIP.

Kjo konferencë ishte ideuar në formën e 3 paneleve të njëpasnjëshme me përfaqësues të institucioneve shtetërore nga Shqipëria dhe Kosova, përfaqësues nga komuniteti i biznesit, partnerë, lektorë të Universitetit të Tiranës, bashkëpunëtorë ndërkombëtarë nga ICC dhe WIPO, të cilët ndanë njohuritë dhe raste konkrete nga praktika e përditshme.





IP4STARTUP - Programi i parë në Shqipëri për trajnimin e startup-ve për Pronësinë Industriale

Është zhvilluar me sukses programi i parë i akselerimit me fokus fuqizimin e sipërmarrjeve përmes mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale, i realizuar në Shqipëri, IP4startups!

Në një mbrëmje të një rëndësie të veçantë për shkak të pjesëmarrjes, të një niveli të lartë teknik dhe përfaqësuesish të drejtorive të inovacionit dhe startup-eve, u bë edhe certifikimi i 10 startup-eve fituese që për 2 muaj rresht kaluan në një trajnim intensiv për Pronësinë Industriale.

Ky program u zbatua nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), me mbështetjen e Projektit Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale (ALSIP).

10 biznese, startup-e, u certifikuan nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Projekti Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale (ALSIP) pas një trajnimi 2-mujor në objektet e Pronësisë Industriale. Programi IP4startups, i ideuar për të informuar bizneset inovative në “luftën” e konkurrencës së pandershme si dhe të qenët të mbrojtur nga ligji në të vetmen “hipotekë” të pronësisë industriale.





Tematikat e trajtuara në mënyrë interaktive gjatë trajnimeve përfshinë të drejtën e autorit, kontratat e punës, patentat për shpikje dhe sekretin tregtar.

Me mbështetjen e ofruar nga programi, startup-et janë tashmë të përgatitura për të regjistruar markën dhe për të mbrojtur asetet e tyre.

Ekspertët nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ofruan ekspertizën e tyre përmes një sesioni interaktiv workshop-i mbi tematikat, si përforcimi (reinforcement), përfitimet ekonomike nga përforcimet, licencimi dhe nënlicencimi.



24 tetor 2024 - Leksion i hapur në Fakultetin e Drejtësisë, Tiranë

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale organizoi sot një leksion të hapur me studentët e Fakultetit të Drejtësisë mbi njohjen e objekteve të Pronësisë Industriale.

Leksioni u mbajt nga prof. dr. Alessandro Cogo nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Torinos si dhe drejtori shkencor i WIPO LLM në PI. Ky leksion u realizua pas kërkesës në World Intellectual Property Organization Academy të Ambasadores së Përhershme në UN, Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë OKB në Gjenevë, të prof. Vasilika Hysi.

Leksioni u përqendrua mbi burimet dhe parimet kryesore të së Drejtës Ndërkombëtare të PI-së dhe ndikimet që sjell prona intelektuale në ekonominë globale. Ky leksion i hapur, i pari i këtij lloji, u përshëndet nga përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale si dhe nga zëvendësdekani, i Fakultetit Juridik.



8 nëntor 2024 – Workshop për prokurorë dhe gjyqtarë me temë “Praktika gjyqësore e Gjykatës Administrative në lidhje me Pronësinë Industriale dhe Intelektuale”

DPPI-ja, së bashku me Projektin Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale (ALSIP) dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, organizuan takimin e përbashkët me temë “Praktika gjyqësore e Gjykatës Administrative në lidhje me Pronësinë Industriale dhe Intelektuale”.

Ky është takimi i tretë i zhvilluar i këtij lloji për të ndarë eksperiencat mes DPPI-së dhe trupës gjyqësore.

Në këtë seancë me Shkollën e Magjistraturës u diskutua:

- ✧ Prezantim mbi organet administrative të DPPI-së që shqyrtojnë konfliktet në fushën e Pronësisë Industriale;
- ✧ E drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të në Republikën e Shqipërisë;
- ✧ Inteligjenca Artificiale (AI) dhe ndikimi i saj në tregun e Pronësisë Intelektuale;
- ✧ Diskutime mbi argumentet lidhur me AI dhe nëse bien nën rregullimet e së drejtës së autorit apo ato të Pronësisë Industriale;
- ✧ Përgjegjësitë civile, penale dhe administrative që burojnë nga veprimet juridike të AI-së;
- ✧ Praktika gjyqësore e Gjykatës Administrative në lidhje me Pronësinë Industriale dhe Intelektuale.



12 dhjetor 2024 - Takim me përfaqësues të autorizuar në kuadër të mbylljes së vitit kalendarik 2024

Në kuadër të mbylljes së vitit kalendarik, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale mirëpriti në takim Përfaqësuesit e Autorizuar për të diskutuar dhe për të shkëmbyer përvojat në shërbimet e marra nga DPPI-ja.

U diskutua për ligjin e Pronësisë Industriale, tarifat, risitë dhe sfidat e sistemit, sidomos pas kalimit të shërbimeve online që nga 1 maji 2022. Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së, znj. Maria Solis Kapedani, u shpreh se institucioni do të konsiderojë secilin nga sugjerimet e propozuara dhe garantoi mbarëvajtjen e bashkëpunimit me ta.



BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE WIPO/ EPO/ EUIPO

13-24 maj 2024 - Miratimi i Traktatit të ri Historik mbi Pronësinë Intelektuale, Burimet Gjenetike dhe Njohuritë Tradicionale të lidhura me të

Kjo konferencë diplomatike e organizuar nga WIPO është faza përfundimtare e negociatave përpara miratimit të një instrumenti juridik ndërkombëtar. Instrumenti i ardhshëm synon “të rrisë efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e sistemit të patentave” dhe “të parandalojë që patentat të jepen gabimisht për shpikjet që nuk janë të reja ose shpikëse në lidhje me burimet gjenetike dhe njohuritë tradicionale të lidhura me burimet gjenetike”.

Ky është traktati i parë i WIPO-s që trajton ndërlidhjen midis Pronës Intelektuale, burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale dhe traktati i parë i WIPO-s që përfshin dispozita posaçërisht për popujt indigjenë si dhe për komunitetet lokale.

Po çfarë sjell ky traktat? Në përgjithësi, kur një shpikje e pretenduar në një aplikim për patentë bazohet në burimet gjenetike, secila palë kontraktuese do t’u kërkojë aplikantëve të zbulojnë vendin e origjinës ose burimin e burimeve gjenetike. Kur shpikja e pretenduar në një aplikim për patentë bazohet në njohuritë tradicionale të lidhura me burimet gjenetike, secila palë kontraktuese do t’u kërkojë aplikantëve që të zbulojnë popujt indigjenë.



3 qershor 2024 - Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e Republikës së Shqipërisë (DPPI) zbaton CP8

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e Republikës së Shqipërisë (DPPI) publikoi një dokument praktik në lidhje me përdorimin e markës tregtare në një formë që ndryshon nga ajo e cila është regjistruar.

Dokumenti, i zhvilluar në kuadër të aktiviteteve të bashkëpunimit ndërkombëtar të këtyre njësive, ka për qëllim të rrisë qartësinë, transparencën, sigurinë ligjore dhe parashikueshmërinë në dobi të përdoruesve dhe ekzaminuesve të zyrave të PI-së. Ky dokument synon gjithashtu të jetë një referencë edhe për të gjitha palët e tjera të interesuara.



18-19 shtator 2024 - Konferenca PATLIB Ankara, Turqi

Konferenca PATLIB 2024 ka në fokusin e saj informacionin bazik mbi patentat, deri në shërbimin mbi njohuritë esenciale të patentave për bizneset.

Qendrat PATLIB janë gjithmonë pjesë e organizatave pritëse, siç janë universitetet, qendrat e tregtisë apo zyrat kombëtare të patentave, duke u bërë pjesë e angazhimit me shpikësit vendas dhe se si ky angazhim ndryshon ndërmjet target-grupeve të ndryshme.



23-25 shtator 2024 - Mision eksperti në fushën e inovacionit me Zyrën Hungareze të Pronësisë Intelektuale në kuadër të instrumentit TAIEX/ EC



Në kuadër të instrumentit TAIEX/ EC, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) pati kënaqësinë të përfitonte nga një mision ekspertësh, duke sjellë një frymë të re bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e inovacionit.

Ky takim synonte të përforconte urat e bashkëpunimit mes dy institucioneve tona, ku është nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi DPPI- HIPO.

Ky mision, i fokusuar në zhvillimin dhe fuqizimin e ekosistemit të inovacionit, përbën një mundësi mjaft të mirë për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira.

Ky bashkëpunim ndërinstitucional jo vetëm që ndihmon në ngritjen e kapaciteteve, por edhe në forcimin e lidhjeve mes inovatorëve të rinj dhe institucioneve të Pronësisë Intelektuale, duke ndërtuar një themel të fortë për të ardhmen e inovacionit në Shqipëri.

1-2 tetor 2024 - Konferenca diplomatike e nivelit të lartë me temë “Pronësia Intelektuale në kohën e Inteligjencës Artificiale” Budapest, Hungari

Kjo konferencë e këtij niveli është e para e mbajtur nga Zyra Hungareze (HIPO) dhe ka një rëndësi të veçantë edhe për faktin se Hungaria tashmë ka marrë presidencën e Bashkimit European. Takimi u nderua edhe nga prezenca e drejtorit të përgjithshëm të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale World Intellectual Property Organization dhe presidenti i European Union Intellectual Property Office – EUIPO.

Për të kuptuar sfidat që Inteligenca Artificiale i sjell botës së Pronësisë Industriale dhe asaj Intelektuale, u bënë bashkë drejtues të zyrave homologe nga e gjithë Europa, por edhe artistë, krijues dhe inovatorë profesionistë të suksesshëm.



5 nëntor 2024 - Workshop për krijimin e një Qendre Transferimi të Teknologjisë

Është zhvilluar në Tiranë workshop-i për të bërë të mundur krijimin e një Qendre Transferimi të Teknologjisë (TTO) në një nga universitetet e vendit tonë. Ky workshop është organizuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI).

Lektorët e WIPO-s ndanë me rektorët dhe përfaqësuesit e universiteteve rëndësinë e Qendrave të Transferimit të Teknologjive, investimit në to dhe akordimit të buxheteve.


Ky ishte takimi i parë i këtij niveli dhe vjen në kuadër të bashkëpunimit afatgjatë.



11-22 nëntor 2024 - Shtetet Anëtare të WIPO-s miratojnë Traktatin e Ligjit të Disenjos Industriale në Riad

Ky traktat i ri do ta bëjë më të lehtë, më të shpejtë dhe më të përballueshëm për disajnerët në mbarë botën mbrojtjen e modeleve të tyre, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Një hap i madh përpara në fuqizimin e stilistëve dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në disajni!



28-29 nëntor 2024 – 125-vjetori i krijimit të Zyrës Austriake të Patentave

Më 28-29 nëntor 2024, Zyra Austriake e Patentave festoi 125-vjetorin e saj, duke shënuar një prej institucioneve më të vjetra dhe më të rëndësishme për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale në Europë. Aktiviteti u mbështetet nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), Zyra Europiane e Patentave (EPO) dhe Zyra e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit European (EUIPO).

Të tre krerët më të lartë të këtyre organizatave kanë përshëndetur **këtë aktivitet, duke theksuar rëndësinë globale të të drejtave të pronësisë intelektuale.**

125-vjetori i Zyrës Austriake të Patentave shënon një histori të pasur në mbështetjen dhe mbrojtjen e inovacionit, duke kontribuar në zhvillimin e teknologjisë dhe ekonomisë së Austrisë.



29 nëntor-6 dhjetor 2024 - Sesioni i 48-të i Komitetit Ndërqeveritar për Pronësinë Intelektuale dhe Burimet Gjenetike, Njohuritë Tradicionale dhe Folklorin (IGC)

Është zhvilluar sesioni i 48-të i Komitetit Ndërqeveritar për Pronësinë Intelektuale dhe Burimet Gjenetike, Njohuritë Tradicionale dhe Folklorin (IGC), ku po diskutohet mbrojtja e pasurive tona kulturore dhe natyrore.

IGC, i mbajtur nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), është një forum i rëndësishëm ku shtetet anëtare punojnë për të siguruar mbrojtjen e njohurive tradicionale (TK), shprehjeve kulturore (TCEs) dhe resurseve gjenetike (GR).



3-4 dhjetor 2024 - Workshop rajonal mbi sistemet XML dhe API në Sistemin e Madridit

Në datat 3 dhe 4 dhjetor 2024 është zhvilluar në Chisinau, kryeqytetin e Moldavisë, workshop-i rajonal i organizuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Industriale (WIPO) në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Pronësisë Industriale të Moldavisë dhe me asistencën e Administratës Kombëtare të Pronësisë Industriale të Kinës.

Workshop-i, me temë “Implementimi i sistemeve XML dhe API për shkëmbimin e informacionit në Sistemin e Madridit për vende të përzgjedhura të Europës Lindore dhe rajoneve pranë tyre”, ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe shkëmbimin efektiv të informacionit ndërmjet zyrave të pronësisë industriale.

Ky aktivitet shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në kuadër të Sistemit të Madridit.



MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT

29 mars 2024 - Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë.




9 maj 2024 – Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë.



5 korrik 2024 - Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Kolegjit Universitar Logos.



24 korrik 2024 - Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Agjencisë së Startup-eve.



3 tetor 2024 - Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Western Balkans University.



26 nëntor 2024 – Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Institutit Kanadez të Teknologjisë.



13 dhjetor 2024 – Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Universitetit European të Tiranës.



VIZITA STUDIMORE NË ZYRAT HOMOLOGE NË FUSHËN E PRONËSISË INTELEKTUALE

8-12 prill 2024 - Vizitë studimore në Zyrën e Pronësisë Intelektuale në Bernë/ Zvicër.



21 maj 2024 - Vizitë zyrtare në Tiranë nga delegacioni i Zyrës Homologe të Kosovës.



27 Maj, 2024- Vizitë Studimore në Beograd/Serbi.



2 tetor 2024 - Vizitë zyrtare në Agjencinë për Pronësi Industriale të Republikës së Kosovës.



Sektori i Promovimit dhe Qendra e Trajnimeve

Si pjesë e Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës, gjatë vitit 2024 ka zhvilluar një sërë takimesh dhe aktiviteteve me qëllim promovimin dhe informimin mbi fushën e Pronësisë Industriale.

Në bazë të Ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, si dhe nga “Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022-2025”, DPPI-ja ka detyrë funksionale regjistrimin, administrimin, promovimin e objekteve të PI-së si dhe informimin e gjithë aktorëve të fushës së Pronësisë Industriale në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit në vend është një nga prioritetet kryesore të punës sonë. Në fokusin e drejtorisë qëndron bashkëpunimi i ngushtë me biznesin, me qëllim informimin e tyre në lidhje me fushën e PI-së. Për përmbushjen e këtyre objektivave, DPPI-ja realizon aktivitete, takime, trajnime, workshop-e të shumta gjatë vitit, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e bizneseve vendase për rëndësinë e regjistrimit të objekteve të PI-së.

Takime me bizneset

Në mbështetje të biznesit vendas, Sektori i Promovimit, me anë të fushatave ndërgjegjësuese mbi objektet e Pronësisë Industriale, ka zhvilluar një sërë takimesh pranë bizneseve në disa nga qytetet e vendit, të planifikuara në kalendarin e fillimvitit (miratuar nga MEKI). Koncretisht:

- 1 shkurt 2024 – Takim me tematikë “Rëndësia dhe procedurat e mbrojtjes së Pronësisë Industriale” në qytetin e Tiranës, me sipërmarrës nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriu, organizuar nga Bloconomy.
- 31 korrik-2 gusht 2024 – Takim me bizneset në qytetin e Vlorës.
- 5-7 gusht 2024 – Takim me bizneset në qytetin e Pogradecit.
- 2-4 shtator 2024 – Takim me bizneset në bashkinë e qytetit të Beratit.
- 18-20 shtator 2024 – Takim me kryetarin e bashkisë së qytetit të Gjirokastrës.
- 2-4 tetor 2024 – Takim me bizneset në qytetin e Sarandës.
- 7-9 tetor 2024 – Takim me bizneset në qytetin e Korçës.
- 9-11 tetor 2024 – Takim me subjektet tregtare të zonës bregdetare Livadh–Borsh.
- 23-25 tetor 2024 – Takim me biznesin në qytetin e Kukësit.
- 4-6 nëntor 2024 – Takim me bizneset në zonën e Himarës.
- 20-22 nëntor 2024 – Takim me bizneset në qytetin e Tropojës.



Takime ndërinstitucionale

Rëndësia e organizimit të prodhuesve vendorë në organizatë për të regjistruar produktet autoktone gjirokastrite ishte edhe qëllimi i takimit të kryetarit të bashkisë Gjirokastër, z. Flamur Golemi dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, znj. Maria Solis Kapedani.

Një takim i frytshëm për të bërë organizmin dhe regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale në këtë bashki, me mbështetjen dhe orientimin e DPPI-së.

Bizneset lokale, prodhuesit vendorë, shoqatat e ngritura mbi qëllimin e mbrojtjes së ekosistemit ekonomik ishte edhe propozimi i drejtpërdrejtë dhe i mirëpranuar për të bërë të mundur mbrojtjen dhe sigurinë që vjen nga regjistrimi i markës, dizenjos industriale dhe treguesve gjeografikë.



27 nëntor 2024

Me kryetaren e bashkisë së Përmetit, znj. Alma Hoxha, u mbajt takimi me qëllimin për të identifikuar format e bashkëpunimit mes bashkisë së këtij qyteti dhe biznesit lokal që operon në këtë zonë.

Bashkëpunimi ynë me këtë bashki synon mbështetjen e prodhuesve të zonës, duke u përqendruar te promovimi dhe mbrojtja e produkteve unike dhe tradicionale të Përmetit.

Të gjitha këto produkte përfaqësojnë një mundësi të artë për të zhvilluar dhe për të mbrojtur trashëgiminë bujqësore dhe kulinare të Përmetit, duke kontribuar jo vetëm në ruajtjen e traditave, por edhe në rritjen e konkurrencës dhe eksportit të këtyre produkteve në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Treguesit gjeografikë, përmes mbrojtjes ligjore që ofrojnë, ndihmojnë në garantimin e cilësisë dhe origjinës së këtyre produkteve, duke përmirësuar reputacionin e tyre dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë lokale.



ARSIMI DHE PI

Trajnime në universitete

Në fokusin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale qëndron bashkëpunimi i ngushtë me sistemin arsimor për ndërgjegjësimin e brezave të rinj në lidhje me fushën.

DPPI-ja organizon çdo vit leksioneve të hapura në auditorët e universiteteve dhe sistemin parauniversitar, një praktikë kjo e krijuar prej disa vitesh, e cila ka rezultuar mjaft e suksesshme në rritjen e ndërgjegjësimin të brezave të rinj.

Qëllimi i leksioneve të zhvilluara është informimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve mbi objektet e PI-së si dhe mënyrat e kërkimit në regjistrat europianë dhe regjistrin e Organizatës Botërore të PI-së.

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e larta arsimore me qëllim promovimin e Pronësisë Industriale, informimin dhe sensibilizimin e studentëve, stafit akademik shkencor dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore shkencore, lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale:

- 25 janar 2024 – Trajnim në Universitetin Europian të Tiranës me temë “Teknologjia dhe inovacioni, Pronësia Intelektuale”.
- 20 mars 2024 – Trajnim me temë “Të njohim rëndësinë e disenjës industriale dhe përfitimet që sjell regjistrimi i saj”, zhvilluar pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.
- 29 mars 2024 – Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër për ngritjen e Qendrës së Informacionit Tekniko-Shkencor pranë këtij universiteti.
- 30 mars 2024 – Trajnim me temë “Kreativiteti dhe inovacioni të brezave të rinj” me studentët e Universitetit Epoka.
- 3 prill 2024 – Trajnim me temë “Të njohim rëndësinë e disenjës industriale dhe përfitimet që sjell regjistrimi i saj” me studentët e Institutit Kanadez të Teknologjisë.
- 5 prill 2024 – Trajnim në eventin “EU for Inovacion” me studentët e Universitetit Metropolitan.
- 29 prill 2024 – Trajnim me temë “Përafrimi i kuadrit ligjor me direktivat e Bashkimit Europian në fushën e PI-së, në kuadër të procesit të negociatave” me studentë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tiranës.
- 16 maj 2024 – Trajnim me temë “Të njohim rëndësinë e disenjës industriale dhe përfitimet që sjell regjistrimi i saj” në Kolegjin Universitar Beder.
- 1 korrik 2024 – Përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) ishin pjesë e aktivitetit me temë “Bioteknologjia dhe të drejtat e Pronësisë Intelektuale, refleksione teorike dhe praktike të legjislacionit dhe jurisprudencës të BE-së dhe perspektivat e legjislacionit të RSH-së”, zhvilluar në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, me ftesë të kësaj të fundit.
- 31 tetor 2024 – Trajnim me temë “Të njohim fushën e Pronësisë Industriale dhe të drejtat që burojnë nga regjistrimi i objekteve të saj”, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.
- 2-4 dhjetor 2024 – Orë e hapur leksioni me tematikën “Si të nxisim studentët për të thelluar njohuritë e tyre në fushën e Pronësisë Industriale” në Universitetin “F. S. Noli”, Korçë.
- 16-18 dhjetor 2024 – Trajnim me temë “Të njohim fushën e Pronësisë Industriale dhe të drejtat që burojnë nga regjistrimi i objekteve të saj” në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër.



5 nëntor 2024

Është zhvilluar në Tiranë workshop-i për të bërë të mundur krijimin e një Qendre Transferimi të Teknologjisë (TTO) në një nga universitetet e vendit tonë. Ky workshop është organizuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI).



Qendra e Trajnimeve

Qendra e Trajnimeve në fushën e Pronësisë Industriale, pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së DPPI-së, organizon aktivitete, kurse, trajnime dhe seminare në fushën e PI-së.

E aksesueshme në mënyrë të thjeshtë nga publiku i interesuar, qendra shërben edhe si “info point” për të dhënë informacion për të gjithë të interesuarit në fushën e Pronësisë Industriale.

Misioni i qendrës është trajnimi i institucioneve të përfshira në mënyrë direkte ose jo në sistemin e mbrojtjes së PI-së, si doganat, gjykatat, Prokuroria, Policia e Krimin Ekonomik, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, përfaqësuesit e autorizuar, ekspertët e PI-së, të nxënësve dhe studentëve dhe shkollave fillore, si publike dhe ato private, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e publikut, biznesit dhe grupeve të interesit.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me strukturat e tjera ligjzbatuese në fushën e Pronësisë Intelektuale pranë Qendrës të Trajnimeve janë zhvilluar takime dhe trajnime me çështje që u përkasin të drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe zbatimit të tyre në Republikën e Shqipërisë.

- 18 janar 2024 – Së bashku me përfaqësues të autorizuar, ndoqëm trajnimin me temë “Hartimi i pretendimeve për ekzaminuesit e patentave dhe përfaqësuesit e autorizuar”, ofruar nga Kostandin Kruti, diplomuar për inxhinieri mekanike dhe me një eksperiencë 2-vjeçare pranë Zyrës Europiane të Patentave të Gjermanisë.
- 25 janar 2024 – Trajnim me temë “Klasifikimi i patentave”, ofruar nga Kostandin Kruti për ekzaminuesit e patentave dhe përfaqësues të autorizuar.
- 26 janar 2024 – Lançimi i Strategjisë së Qendrës së Trajnimeve 2023-2028.
- 27 shkurt 2024 – Qendra e Trajnimeve, në bashkëpunim me ekspertët e EUIPO, zhvilluan trajnim online në lidhje me praktikën e punës, si CP3 dhe CP5, për ekzaminimin e markave tregtare dhe përfaqësues të autorizuar.
- 29-31 korrik 2024 – Trajnimi online “Objektet e Pronësisë Industriale, procedura dhe rëndësia e regjistrimit”. Për tri ditë me radhë, ekspertët tanë ofruan njohuri të thelluara mbi Pronësinë Industriale, duke mbuluar temat kyçe, si markat tregtare, disenjot industriale, treguesit gjeografikë dhe patentat për shpikje.





OBJEKTET E PRONËSË INDUSTRIALE, PROCEDURA DHE RËNDËSIA REGJISTRIMIT

MEET OUR SPEAKER



BRUNILDA ÇUKO
Konsulent e Shërbimeve të Pronësive dhe Kualitetit të Produkteve të Çështurës dhe Përgjithshme të Procesit të Produksionit



LINEDA ARAPA
Përgjithësi e Inovacionit të Shërbimeve të Markës, Qëndrueshmërisë dhe Traditës së Kompanive të Drejtuarit e Ekonomisë



ENEIDA SHIROKA
Përgjithësi e Shërbimeve të Pronësive dhe Kualitetit të Produkteve të Çështurës dhe Përgjithshme të Procesit të Produksionit



SUELA QATIPË
Konsulent e Shërbimeve të Pronësive dhe Kualitetit të Produkteve të Çështurës dhe Përgjithshme të Procesit të Produksionit

PËRSHKRIMI I TRAJNIMIT:

Ky trajnim synon të ofrojë një kuptim të thelluar mbi pronësinë industriale, duke përfshirë njohuri bazë dhe procedurat e regjistrimit për marka tregtare, dizajne industriale, tregues gjeografikë dhe patenta për shpikje.

TEMAT E TRAJNIMIT:

- Njohuri bazë mbi Pronësinë Intelektuale
- Markat Tregtare
- Dizajne Industriale
- Treguesi Gjeografikë
- Procedura e Regjistrimit për Markat Tregtare, Dizajne Industriale dhe Tregues Gjeografikë
- Patentat për shpikje: Njohuri bazë dhe procedura e regjistrimit

26 janar 2024


Prezantuar një fazë të re mbi ecurinë dhe forcimin e Qendrës së Trajnimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, lançimin e strategjisë për këtë qendër.

Së bashku me të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë të këtij rrugëtimi, finalizuam me sukses Strategjinë e Qendrës për një periudhë 5-vjeçare, 2023-2028.

Qëllimi i kësaj strategjie është të ofrojë për çdo grup interesi informacione dhe trajnime mbi fushën, të sigurojë një mjedis të përmirësuar me metodat bashkëkohore dhe të stimulojë inovacionin, shkencën dhe teknologjinë.

Roli i partnerëve kombëtarë dhe atij ndërkombëtar, Projektit Shqiptaro-Zviceran ALSIP, mundësoi krijimin e një dokumenti strategjik të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe produktiv për Qendrën e Trajnimeve.

Një falënderim i veçantë për Projektin Shqiptaro-Zviceran ALSIP, si dhe ekspertin, z. Andreas Kurt, i cili udhëhoqi këtë strategji.




AKTIVITETE TË TJERA

Pjesëmarrje në panairë

9-10 tetor 2024

Për herë të parë DPPI-ja merr pjesë në panairin e inovacionit, “Future2Tech”, ku nëpërmjet një stende përfaqësues të DPPI-së informuan pjesëmarrësit mbi rëndësinë e regjistrimit të patentave për shpikje dhe modeleve të përdorimit. Ky event, i cili konsiderohet ndër më të rëndësishmit për teknologjinë dhe inovacionin, bëri bashkë një numër të madh kompanish nga vendi dhe rajoni, nga ku u promovuan produktet dhe shërbimet e tyre. Në hapësirën e dedikuar për DPPI-në u zhvilluan takime informuese me të rinjtë dhe pjesëmarrësit e panairit dhe u informuan mbi rëndësinë e regjistrimit të objekteve të PI-së, në veçanti mbi patentimin dhe shpikjet e fundit, *të patentuara në botë*.

Për të gjithë kureshtarët dhe të interesuarit rreth shpikjeve, përfaqësuesit tanë prezantuan edhe programin “ESPASNET”, një motor kërkimi në gjuhën shqipe ku studentët, të rinjtë dhe çdo i interesuar marrin informacion mbi patentat e dhëna për shpikjet në të gjithë botën.



11-13 tetor 2024

Në datat 11-13 tetor 2024, DPPI-ja merr pjesë në panairin më të madh të artizanatit, “TiranAgro”, i cili mbledhi aktorët më të rëndësishëm të tregut vendas, konsumatorë, investitorë si dhe biznese të sektorëve të produkteve të konsumit. Në stendën e dedikuar prodhuesve, bizneseve dhe pjesëmarrësve të panairit, përfaqësues të DPPI-së informuan të interesuarit rreth fushës së DPPI-së si dhe përfitimet e sjella nga regjistrimi i objekteve të saj. Në takimet që drejtorja zhvilloi përgjatë këtyre ditëve synoi identifikimin e produkteve me potenciale të mundshme për treguesit gjeografikë, identifikimin e zonave përkatëse si dhe promovimin e bizneseve me produkte të prodhuara në Shqipëri.



16 nëntor 2025

U mbajt në Peshkopi panairi “Shije dhe traditë” si dhe takimi informues dedikuar prodhuesve dhe fermerëve të qarkut Dibër për identifikimin e produkteve me potencial të mundshëm regjistrimi si Tregues Gjeografikë.

Ky aktivitet u zhvillua nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale në bashkëpunim me Bashkinë Peshkopi dhe me mbështetje të Projektit Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intellektuale (ALSIP).

Fermerët dhe prodhuesit e qarkut Dibër u njohën në mënyrë të detajuar me hapat dhe rëndësinë e regjistrimit të produkteve karakteristike të zonës me potencial si Tregues Gjeografikë.

Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së, znj. Maria Solis Kapedani, kryetari i Bashkisë Dibër, z. Rahim Spahiu, si dhe znj. Borana Kalemi, menaxhere e projektit në ALSIP, theksuan rëndësinë e bashkëpunimit mes fermerëve dhe prodhuesve vendorë për t'u organizuar në shoqata për regjistrimin dhe mbrojtjen e produkteve si Tregues Gjeografikë.

Të pranishmit në këtë panair vlerësuan këtë event si dhe shprehën qartë nevojën e organizimit në shoqata, në mënyrë që të regjistrojnë produktet e zonës së tyre me potencial si Tregues Gjeografikë.



27 nëntor 2024

Me prodhues dhe artizanë të qytetit të Përmetit patëm mundësinë të diskutonim mbi fushën e Pronësisë Industriale dhe veçanërisht mbi rëndësinë e regjistrimit të produkteve të zonës si tregues gjeografikë dhe emërtime origjine.

Pjesë e panelit referues ishte znj. Brunilda Shamo, eksperte e fushës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila foli në aspekt më të gjerë lidhur me produktet me potencial regjistrimi si tregues gjeografikë dhe rëndësia e organizimit në shoqata për këtë qëllim.

Gjithashtu, theksuam domosdoshmërinë e regjistrimit të produkteve me potencial si tregues gjeografikë, si një indikator i rëndësishëm në promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e ekonomisë lokale dhe pasurimin e gamës së produkteve autentike shqiptare.




Trajnime në fushën e Pronësisë Intelektuale me Startup

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, **në bashkëpunim me Agjencinë e Startup-it** dhe Drejtorinë për të Drejtën e Autorit, organizuan ciklin e parë të trajnimeve me fokus informimin e startup-eve në lidhje me portofolin e Pronësisë Intelektuale.

Përfaqësuesit e dy institucioneve përgjegjëse për Pronësinë Intelektuale referuan për pjesëmarrësit temat:

- Të njohim fushën e Pronësisë Intelektuale dhe të drejtat që burojnë nga regjistrimi i objekteve të saj;
- Të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to;
- Procedurat e regjistrimit të markës tregtare dhe procedurat e regjistrimit të disenjosh industriale;
- Si mbrohen patentat dhe modelet e përdorimit në Republikën e Shqipërisë, kushtet dhe procedurat e regjistrimit;
- Mbrojtja ndërkombëtare e objekteve të PI-së.

Të pranishmit në ciklin e parë të këtij trajnimi u shprehën entuziastë mbi cilësinë dhe sasinë e informacionit të dhënë për ta dhe se sa e rëndësishme është regjistrimi i objekteve të Pronësisë Industriale dhe Intelektuale që në fazat e para të konceptimit të sipërmarrjes.



23 qershor 2024

Me ftesë të Partners Albania for Change and Development, kishim kënaqësi të ishim pjesë e thirrjes së parë që Partners Albania ka parashikuar për vitin 2024 për startup dhe sektorin e biznesit.

Të fokusuar në tematikat e Pronësisë Industriale, pjesëmarrësit patën mundësi të njiheshin me procedurat, rëndësinë si dhe përfitimet që i sjell regjistrimi i objekteve të PI-së biznesit.

Përfaqësuesit ndanë konceptet e fushës me të pranishmit si dhe prezantuan “IP prediagnostics tool”, një mjet vetëvlerësimi i Pronësisë Intelktuale për bizneset e vogla dhe sipërmarrësit e rinj.

DPPI-ja ofron mbështetje dhe asistencë për çdo subjekt të interesuar dhe çdo startup që të jetë i mbrojtur në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.




Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale, 26 prill

Në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale (26 prill), Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, nëpërmjet stendës së ngritur në qytetin e Tiranës, mundësoi shpërndarjen e broshurave dhe materialeve promovuese mbi objektet e PI-së.

Nën sloganin “Ndërtimi i së ardhmes sonë të përbashkët në inovacion dhe kreativitet” lançuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI) kushtuar kësaj dite, informuam mbi rëndësinë e saj.

Së bashku me përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, mirëpritëm të rinj përfaqësues nga biznesi dhe sipërmarrës të rinj që shfaqën interes për më shumë informacion rreth fushës së Pi-së, mbrojtjes së produkteve dhe mallrave nga falsifikimi.



Konkursi me nxënës të sistemit parauniversitar

Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale (26 prill) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e festoi këtë vit mes entuziazmit, energjisë dhe ideve inovatore të nxënësve pjesëmarrës në konkursin me temë “Ne krijojmë për planetin” që DPPI-ja kishte ideuar për të festuar e për të promovuar në këtë ditë.

Një traditë e krijuar tashmë prej vitesh, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në bashkëpunim me projektin “SANECA”, financuar nga qeveria gjermane dhe zbatuar nga GIZ Albania (Bashkëpunimi Gjerman për Shqipërinë), organizuan në mjediset e “Reja” konkursin me institucionet e arsimit parauniversitar të qytetit të Tiranës.

Nxënësit e qytetit të Tiranës shprehën idetë e tyre krijuese drejt një të ardhmeje më të pastër dhe sa më të gjelbër.

Konkursi u përshëndet me fjalën e zëvendësministrit të MEKI-t, z. Endrit Yzeiraj, i cili shprehu vlerësimin maksimal për këtë aktivitet dhe ofroi mbështetjen e tij për të inkurajuar këta nxënës që idetë e tyre t’i bëjmë realitet.

Për të gjithë nxënësit u shpërndanë materiale promovuese dhe secili prej tyre u shpërblye me certifikatë pjesëmarrjeje.

Krijimet më të mira në fushën e inovacionit dhe disenjos industriale u vlerësuan me çmime simbolike nga partneri ynë mbështetës GIZ Albania.

Në morinë e punimeve tepër të veçanta të këtyre nxënësve, juria e konkursit vlerësoi me çmime këto shkolla:

- Fituesi i vendit të parë ishte Kolegji “Turgut Ozal”, çmimi: një tablet.
- Fituesi i vendit të dytë ishte Gjimnazi “Petro Nini Luarasi”, çmimi: një kupton për blerje mjetesh shkollore.
- Fituesi i vendit të tretë ishte Shkolla 9-vjeçare “17 Shkurti”, çmimi: një kupton për blerje mjetesh shkollore.

Në përfundim të eventit, Drejtori i Përgjithshëm i komanduar i DPPI-së falënderoi bashkëpunëtorët, nxënësit, së bashku me mësuesit udhëheqës për angazhimin dhe përkushtimin e treguar në realizimin e këtij konkursi.

Gëzimi i reflektuar në portretet e nxënësve na bën të jemi mbështetësit e tyre kryesorë për të çuar përpara idetë e tyre inovatore në krijimin e një mjedisi sa më të pastër dhe të gjelbër për të gjithë ne.



DPPI NË MEDIA

Pjesëmarrja e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale në media përgjatë vitit 2024 ka qenë si më poshtë vijon:

Në tetor 2024 Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar, znj. Maria Solis Kapedani ka dhënë një intervistë të posaçme në revistën ekonomike “Monitor”. Intervista mban titullin “Interes i lartë për të regjistruar Pronësinë Industriale”.

Në datën 9 tetor 2024, Drejtori i komanduar I Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, znj. Maria Solis Kapedani ka dhënë një intervistë për të shpjeguar rëndësinë e regjistrimit të objekteve të Pronësisë Industriale. Pse është kaq shumë e rëndësishme që komuniteti i biznesit dhe sipërmarrjes të bëjnë regjistrimin e pronësisë së tyre industriale. Intervista është zhvilluar për televizionin ekonomik, SCAN TV me gazetaren Elisabeta Dosku.

Në datën 13 dhjetor 2024, revista ekonomike “Business Mag” I ka dedikuar një artikull DPPI-së mbi rëndësinë e regjistrimit të Pronësisë Industriale dhe garancia që përfitojnë bizneset e regjistruara. Tema e këtij artikulli është “Mbrojtja e biznesit nga spiunazhi industrial përmes regjistrimit të pronësisë industriale”.

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale vlerësohet me çmimin si institucioni me i mirë i “Menaxhimit të Pronësisë Intelektuale”

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, në 128- vjetorin e saj, vlerëson Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, si institucioni me i mirë i “Menaxhimit të Pronësisë Intelektuale”.

Drejtoresha e Komanduar e DPPI, znj. Maria Solis u shpreh se ky çmim është një deshmi e përkushtimit të vazhdueshëm për të ndihmuar bizneset të rrisin vlerën e tyre përmes inovacionit dhe mbrojtjes së ideve të reja. Në fjalën e saj, ajo theksoi se regjistrimi në QKB nuk domethënë regjistrim të aseteve të pronësisë industriale.

Ky vlerësim konfirmon angazhimin e DPPI-së me mbështetjen e MEKI në rrugën drejt inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshem në tregun shqiptar, duke kontribuar në krijimin e një klime të favorshme për bizneset dhe ndërmarrjet e reja.



INICIATIVA LIGJORE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE

SEKTORI JURIDIK



Mbrojtja e të drejtave mbi objektet e Pronësisë Industriale është një nga aspektet më të rëndësishme të rregulluara nga legjislacioni mbi Pronësinë Industriale.

Sektori Juridik ka si objekt kryesor të veprimtarisë së tij asistimin në sigurimin e praktikave të punës të sektorëve të tjerë të drejtorisë që të jenë në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi “Për pronësinë industriale”, aktet nënligjore dalë në zbatim të tij dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Industriale; të përgatisë praktikat për miratimin ose ndryshimet në aktet ligjore, nënligjore ose aktet e brendshme të drejtorisë, të cilat rregullojnë veprimtarinë funksionale të Drejtorisë; të ndjekë të gjitha çështjet në Gjykatë, ku DPPI-ja është i paditur apo person i tretë.

Përmirësimi i vazhdueshëm i bazës ligjore me qëllim përafrimin me legjislacionin dhe standardet e vendeve të BE-së është në fokusin e veprimtarisë së DPPI-së.

Mbrojtja e të drejtave mbi objektet e Pronësisë Industriale është një nga aspektet më të rëndësishme të rregulluara nga legjislacioni mbi Pronësinë Industriale.

1. Janë ripunuar në bazë të komenteve të ministrive të linjës dhe përcjellë për miratim 2 projektligjet si më poshtë:

Të dyja projektligjet kanë kaluar dy procese konsultimi, për shkak të ndryshimit të emërimit të ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë procesi i konsultimit filloi me publikimin në RENJK të njoftimit paraprak sipas legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik në periudhën 1.12.2023-28.12.2023. Gjithashtu, projektligjet i janë përcjellë për mendim pranë zyrës së kryenegociatorit, MEPJ, MD, AKSHI dhe KLGJ. Në datën 16.12.2023 u zhvillua një takim me përfaqësuesit e autorizuar të objekteve të PI-së, ku diskutuan rreth sugjerimeve dhe komente për projektligjin. Janë reflektuar komentet dhe sugjerimet e institucioneve përkatëse.

Më pas projektligjet kaluan edhe një herë procesin e konsultimit në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Nga ky proces konsultimi DPPI-ja ka reflektuar komentet dhe sugjerimet e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme. Pasi janë reflektuar disa prej komenteve dhe sugjerimeve, DPPI-ja ka dërguar edhe një herë pranë MEKI-t paketat e plota të dy projektligjeve, të cilat në vijim janë dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave.

Këto dy projektligje janë parashikuar në PKIE të miratohen në vitin 2025.

Pas miratimit të tyre DPPI-ja do të fillojë punën për hartimin e projektvendimeve.

a) *Projektligji për Patentat dhe Modelet e Përdorimit, me gjithë dokumentacionin shoqërues:*

- *Raporti RIA (shqip);*
- *Relacion Shoqërues;*
- *Tabela e përputhshmërisë (shqip-anglisht);*
- *Versioni në gjuhën shqipe dhe angleze i projektligjit për të ri “Për Patentat dhe Modelet e Përdorimit”.*

b) *Projektligji “Për Markat Tregtare dhe të Shërbimit” me gjithë dokumentacionin shoqërues:*

- *Raporti RIA (shqip);*
- *Relacion Shoqërues;*
- *Tabela e përputhshmërisë (shqip-anglisht).*

2. Hartimi dhe miratimi i dy projektligjeve:

- “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Singaporit mbi ligjin e Markave Tregtare”. Me këtë projektligj, me aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Singaporit mbi ligjin e Markave Tregtare, synohet të krijohet një kuadër ndërkombëtar modern dhe dinamik për harmonizimin e procedurave administrative të regjistrimit të markave tregtare. Duke u bazuar në Traktatin e Ligjit për Markat Tregtare të vitit 1994 (TLT), Traktati i Singaporit ka një fushë më të gjerë zbatimi dhe trajton zhvillimet më të fundit në fushën e teknologjive të komunikimit.

- “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Najrobit për mbrojtjen e simbolit olimpik”. Me këtë projektligj, me aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Najrobit për mbrojtjen e simbolit olimpik, synon përdorimin e simbolit olimpik - pesë unaza të ndërthurura - kundër përdorimit për qëllime tregtare (në reklama, në mallra, si markë etj.) Çdo shtet palë në këtë traktat do të jetë i detyruar të refuzojë ose të zhvlerësojë regjistrimin si markë dhe të ndalojë me masat e duhura përdorimin, si markë ose shenjë, për qëllime tregtare, të çdo shenje që përbëhet ose përmban Simbolin Olimpik, siç përcaktohet në Kartën e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, përveçse me autorizimin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Aktualisht, këto dy projektligje janë dërguar në MEKI dhe ndodhen në proces konsultimi me institucionet e linjës.

3. Janë hartuar projektvendimet si më poshtë:

- Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 457, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e procedurave për pjesëmarrje në Qendrën e Trajnimeve në fushën e Pronësisë Industriale, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse, në këtë projektvendim”. Në këtë projektvendim synohet të përcaktohet masa e shpërblimit të lektorëve të cilët ofrojnë trajnime në fushën e Pronësisë Industriale, pranë Qendrës së Trajnimeve.

- Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 752, datë 19.12.2018, ‘Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale’”. Qëllimi i hartimit të këtij akti është rregullimi i masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Apelit në proporcion me natyrën e vështirësisë së punës dhe rëndësisë që ajo ka.
- Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 252, datë 9.5.2018, ‘Për përcaktimin e masës dhe të kriterëve për shpërblimin e kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit teknik të Këshillit mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale’”. Qëllimi i këtij projektvendimi është për ndryshimin e masës së shpërblimit të kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit teknik të Këshillit Mbikëqyrës të DPPI-së, i cili mbikëqyr veprimtarinë e punës të DPPI-së.
- Projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike’”, i ndryshuar. Qëllimi propozimit të këtij projektvendimi është shtesa për natyrë të veçantë pune të kryetarit dhe anëtarëve të dhomës për shfuqizim/ zhvlerësim.

Këto projektvendime janë dërguar së bashku me relacionet shpjeguese në MEKI dhe jemi në pritje për miratimin e tyre.

4. Përfaqësuesit e Sektorit Juridik janë anëtarë të Kapitullit 7 “Për pronësinë intelektuale” dhe kryesojnë nëngrupin “Për pronësinë industriale”, të cilët kanë pasur rol kryesor në *procesin screening, duke bërë prezantimet e tyre përpara përfaqësuesve të BE-së*.

Gjithashtu, ka ndjekur në vazhdimësi dhe ka dhënë kontribut në hartimin e PKIE për pjesën e Pronësisë Industriale si dhe kanë marrë pjesë në takimet e organizuara për raportim në lidhje me këtë kapitull. Po ashtu, ka ndjekur edhe procesin e punës së kryer të anëtarëve të tjerë të nëngrupit.

5. Sektorit Juridik si anëtar grupi i Kapitullit 3 “E drejta e vendosjes, liria për të ofruar shërbime” ka dhënë kontributin e tij në lidhje me kapitullin.
6. Ka dhënë kontribut në lidhje me hartimin e PKIE 2025-2027, në lidhje me aktet e parashikuara nga DPPI-ja për miratim.

DHOMA PËR SHFUQIZIM / ZHVLERËSIM

Spektori Juridik është edhe pjesë e dhomës për shfuqizim/ zhvlerësim, ku luan rolin e kryetarit dhe anëtarëve të kësaj dhome. Pranë dhomës për shfuqizim/ zhvlerësim gjatë vitit të fundit janë depozituar në total 24 kërkesa, prej të cilave:

- 19 kërkesa për shfuqizim marke;
- 2 kërkesa për zhvlerësim marke;
- 3 kërkesa për apelimin e vendimeve të refuzimit të regjistrimit të markës.

Në lidhje me këto kërkesa, nga 19 kërkesa për shfuqizim, dhoma ka pranuar kërkesën për 5 raste dhe ka refuzuar kërkesën për 6 raste;

8 kërkesa janë në proces shqyrtimi.

Nga 11 vendime të marra nga dhoma, 6 vendime janë apeluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Nga kërkesa për zhvlerësim, dhoma ka pranuar kërkesën për 1 rast dhe 1 rast është në proces.

Vendimi ku është pranuar kërkesa për zhvlerësim është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Nga 7 kërkesa për apelimin e vendimeve të refuzimit të regjistrimit të markës, dhoma ka pranuar kërkesën për 6 raste dhe ka refuzuar kërkesën për 1 rast.

Asnjë vendim nuk është apeluar në gjykatë.

ÇËSHTJE NË GJYKATË

Përfaqësimi i DPPI-së në çështjet gjyqësore me objekt të drejtat e Pronësisë Industriale

Gjatë vitit 2024, me autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm, janë ndjekur 22 çështje në gjykatë. DPPI-ja përfaqësohet në gjykatë në rastet kur ankimohen vendimet e Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, Dhomës për Shfuqizim/ Zhvlerësim dhe Bordit të Apelit, në të cilat DPPI-ja merr pjesë në gjykim si palë e paditur dhe bën mbrojtjen e vendimeve të saj me anë të prapësimeve, shpjegimeve dhe provave që paraqet në gjykatë. Gjithashtu, DPPI-ja merr pjesë në proceset gjyqësore si person i tretë edhe në çështje me objekt zhvlerësimin, shfuqizimin e markave, konkurrencën e pandershme etj.

Gjatë vitit 2024 DPPI-ja ka ndjekur 22 çështje në gjykatë.

- 5 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë;
- 12 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë;
- 4 çështje në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë;
- 1 çështje në Gjykatën e Lartë.

Nga totali prej 22 çështjesh gjyqësore, në 1 çështje Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë dhe lënien në fuqi të vendimit të Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve. Në 1 çështje Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

Gjykata Administrative të Apelit ka lënë në fuqi 1 vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe vendimin e Bordit të Apelit. Në 1 çështje në Gjykatën Administrative të Apelit palët kanë arritur në marrëveshje.

18 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor janë ende në proces shqyrtimi.

FINANCA DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE

Burimet Njerëzore janë përgjegjëse për rekrutimin, përzgjedhjen, trajnimin, zhvillimin, vlerësimin si dhe shpërblimin e punonjësve.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve.

Një nga objektivat tanë kryesorë është zhvillimi i kapitalit njerëzor, pasi besojmë fort se stafi ynë është kapitali më i rëndësishëm dhe një burim strategjik i institucionit.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë rekrutuar pranë DPPI-së në total 10 (dhjetë) punonjës me kontratë me kohë të pjesshme, 1 (një) punonjës nëpërmjet DAP-it, sipas ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Kreu IV, pika 19.

TË ARDHURAT

Aktiviteti i DPPI-së është përqendruar jo vetëm në zbatimin e funksionit të saj për regjistrimin dhe administrimin e objekteve të Pronësisë Industriale, por edhe në forcimin e rolit të saj si institucioni përgjegjës për të nxitur individët dhe shoqëritë tregtare të regjistrojnë pronën e tyre industriale, si një investim që i shërben së ardhmes së biznesit.

Të ardhurat e DPPI-së përbëhen nga:

1. Aktiviteti kryesor, aplikime kombëtare;
2. Investime të trashëguara, projekte në vazhdim;
3. Të ardhurat nga mbrojtja e markave nga Marrëveshja e Madridit dhe Protokollit i saj për regjistrimin ndërkombëtar të markave;
4. Marrëveshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove;
5. Të ardhura nga ZEP për regjistrimin ndërkombëtar të patentave.

PROCESI I INTEGRIMIT EUROPIAN

Anëtarësimi në Bashkimin Europian është prioriteti strategjik i Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare hyri në fuqi më datë 1 prill 2009.

Më datë 28 prill 2009, Shqipëria aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Europian. Këshilli i Bashkimit Europian vendosi që t'i japë Shqipërisë statusin e vendit kandidat në qershor 2014 dhe në mars 2020 vendosi hapjen e negociatave të anëtarësimin. Vendimi i Këshillit për hapjen e negociatave të anëtarësimin ishte një rrjedhojë logjike e arritjeve të Shqipërisë në reformat e saj të thella, veçanërisht në lidhje me reformën në drejtësi.

Ky vendim shërbeu për t'i dhënë një shtysë të mëtejshme procesit të reformave të nevojshme, për ta përgatitur Shqipërinë për nisjen më pas të negociatave të anëtarësimin. Aktualisht, Shqipëria i ka përmbushur të gjitha kushtet për zhvillimin e konferencës së parë ndërqeveritare. Shqipëria ka ngritur kuadrin e plotë institucional për negociatat e anëtarësimin dhe është duke përgatitur këto struktura për procesin e negociatave të anëtarësimin.

*Komisioni Europian në Kapitullin 7 të raportit të vitit 2023 për Republikën e Shqipërisë është shprehur se: **Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje/ është e përgatitur në mënyrë të moderuar për të drejtat e Pronësisë Intelektuale.** Progres i mirë u bë gjatë periudhës së raportimit, veçanërisht me miratimin e “Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025” dhe harmonizimin legjislativ me *acquis* të BE-së, në fushat e së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera në lidhje me to, si dhe të drejtave për pronën industriale.*

Në vitin e ardhshëm, Republika e Shqipërisë duhet veçanërisht:

1. Të miratojë legjislacionin e zbatueshëm për ndryshimet ndaj ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera në lidhje me to;
2. Të vijojë të përmirësojë funksionimin e organizatave të menaxhimit kolektiv dhe pagesën e të ardhurave ndaj mbajtësit të të drejtave;
3. Të harmonizojë më tej legjislacionin për të drejtat e pronës industriale dhe sistemin e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Shqipëria është një vend me traditë afro 100-vjeçare në fushën e Pronësisë Intelektuale. Gjurmët e para datojnë rreth viteve 1920 me regjistrimin e markës “Hobdari”. Janë burimet arkivore ato që na mundësojnë të mësojmë se Republika e Shqipërisë mund të renditet denjësisht krahas vendeve të rajonit e më gjerë si një vend ku marka dhe rëndësia e mbrojtjes së saj nuk i kanë fillesat tani, por qysh në fillimet e shekullit XX.

Gjithmonë e hapur për harmonizimin e standardeve ndërkombëtare të mbrojtjes së pronës intelektuale, Republika e Shqipërisë ka aderuar në një numër të madh të konventave ndërkombëtare në këtë fushë. Procesi i anëtarësimin në Bashkimin Europian është në vetvete një proces gjithëpërfshirës, pra multisektorial. Anëtarësimi kërkon reforma të thella dhe të gjithanshme, që prekin të gjithë sektorët e qeverisjes, duke synuar transformimin e plotë të kuadrin ligjor dhe institucional, ekonomisë dhe të bërit biznes etj.

Veçoritë e procesit të anëtarësimin në Bashkimin Europian përcaktojnë edhe rolin dhe mënyrën se si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) ushtron detyrat e saj.

Në këtë kuadër, më datë 19-20 janar 2023, pas dy takimesh paraprake *screening* (shkurt 2019 dhe tetor 2022) në Bruksel, u zhvillua takimi bilateral midis Shqipërisë dhe BE-së për Kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale”. Palët shqyrtuan kuadrin ligjor shqiptar për të gjitha çështjet e Pronësisë Intelektuale, që nga pronësia industriale deri tek e drejta e autorit, si dhe nivelin e zbatimit.

STRATEGJIA E RE KOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE 2022-2025

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në rolin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës, ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr. 118, datë 23.9.2020, si dhe me mbështetjen e institucioneve të përfshira në këtë proces, ka propozuar hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të PI-së.

Strategjia e re Kombëtare e PI-së do të përmbajë një grup rregullash, të cilat do të përcaktohen dhe do të implementohen nga institucionet e përfshira në sistemin e PI-së për të inkurajuar dhe për të forcuar zhvillimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e PI-së në nivel kombëtar. Ajo do të konkretizojë përpjekjen themelore për vendosjen e dialogut gjithëpërfshirës ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke krijuar kushte të përshtatshme për mbrojtjen e Pronësisë Intelktuale.

Qëllimet e kësaj strategjie janë:

- Stimulimi i zhvillimit ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend;
- Sigurimi i mirëfunksionimit të tregut të brendshëm, duke vendosur ekuilibrin e duhur midis interesave të pronarëve të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe interesave të përdoruesve;
- Forcimi i sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së Pronësisë Intelktuale.

Strategjia parashikon pesë objektiva:

1. Përmirësimi i kornizës ligjore;
2. Zhvillimi dhe forcimi i kornizës institucionale;
3. Forcimi i koordinimit dhe i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, si në nivelin kombëtar, rajonal, ashtu edhe atë ndërkombëtar;
4. Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e sistemit të Pronësisë Intelktuale;
5. Identifikimi i treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës.

Nëpërmjet kësaj Strategjie, rezultatet që pritet të arrihen janë:

- Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe legjislativ në fushën e Pronësisë Intelktuale;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të institucioneve të përfshira në sistemin e PI-së;
- Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut (organizimi i seminareve, konferencave dhe aktiviteteve promovuese);
- Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve të përfshira në fushën e PI-së;
- Forcimi i sistemit të zbatimit dhe të mbrojtjes së PI-së;
- Nxitja dhe hartimi i politikave për regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, si aset dhe interes kombëtar;
- Komercializimi i objekteve të PI-së, si dhe transferimi i teknologjisë.

Ky dokument u hartua me kontributin e ekspertëve të Grupit Ndërinstitucional të Punës, të ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 118, datë 23.09.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të dokumentit strategjik për Pronësinë Intelektuale 2021-2025” si dhe me asistencën teknike të ofruar nga ekspertët e Organizatës Botërore për Pronësinë Intelektuale (OBPI) si një nga partnerët tanë më të rëndësishëm në rrugëtimin e institucioneve për një sistem të qëndrueshëm të Pronësisë Intelektuale.

Kjo strategji është një nga arritjet më të rëndësishme në reformat që ka ndërmarrë qeveria shqiptare në fushën e Pronësisë Intelektuale, si një gur themeli dhe hap i domosdoshëm drejt procesit të integritit evropian, çka tregon se institucionet shqiptare dinë të ndërmarrin reforma dhe t’i kthejnë ato në objektiva të matshëm dhe të arritshëm. Ndaj, miratimi i dokumenteve të tilla strategjike është një provë e përmirësimit të punës dhe të veprimtarisë së institucioneve.

12 qershor 2024 - Mbledhja e Grupit Ndërinstitucional të Punës për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025 dhe për arritjen e objektivave për 6-mujorin e dytë të vitit 2024.



U zhvillua mbledhja e parë për vitin 2024 e Grupit Ndërinstitucional të Punës për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025.

Me pjesëmarrjen e gjithë institucioneve, u diskutuan bashkërisht arritjet e parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë për 6-mujorin e parë si dhe detyrat kryesore për të përmbushur për 6-mujorin e dytë të vitit 2024.

20 dhjetor 2024 - Mbledhja e Grupit Ndërinstitucional të Punës për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025 edhe për 6- mujorin e dytë të vitit 2024.

U zhvillua mbledhja dytë për vitin 2024 e Grupit Ndërinstitucional të Punës për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025. U diskutuan mbi arritjet për 6-mujorin e dytë për vitin 2024, gjithashtu, edhe sfidat e reja për përgatitjen e draft Strategjinë të re për Pronësinë Intelektuale 2026-2030.

Mirënjohje

Ky raport u hartua falë punës dhe përkushtimit të punonjësve të DPPI-së.

Kontakte: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)

Adresa: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr. 33, ish-Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri.

Website: www.dppi.gov.al

e-mail: info@dppi.gov.al



Facebook: Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale



Instagram: Dppi Albania



LinkedIn: Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

Numri i Gjellbër: **0800 1993**